



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti Juridik

Studime Postdiplomike – Master

Tema : „ Viktimat e krimeve të vrasjeve në Republikën e Maqedonisë

Mentor:

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Kandidati:

Feta Fetai

Tetovë , 2016

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
2. Arsyeshmëria e hulumtimit të viktimave të vrasjeve.....	6
3. Metodologjia e Punës.....	7

KAPITULLI I PARË

Vështrim i përgjithshëm mbi viktimat e krimeve të vrasjeve.....8

1. Viktimat e krimeve të vrasjeve si lloj i veçantë i krimeve të dhunës.....	9
1.1 Nocioni për viktimat e krimeve të vrasjeve.....	9
1.2 Kuptimi i viktimës dhe viktimizimit.....	10
1.3 Raporti në mes viktimës dhe kryerësit të vrasjes.....	11
1.4 Klasifikimi dhe tipologjia e viktimave.....	12
1.5 Kategoritë dhe faktorët e rrezikut.....	17
1.6 Studimet mbi viktimat.....	19

KAPITULLI I DYTË

Vështrimi viktimologjik mbi viktimat e krimeve të vrasjeve në Maqedoni

1. Marrja e jetës si vepër penale.....	20
2. Viktimat e krimeve të vrasjeve në Maqedoni gjatë periudhës 2005-2015.....	22
3. Karakteristikat e krimeve të vrasjeve në territorin e Maqedonisë nga viti 2005-2015.....	22
3.1 Motivet e viktimizimit të vrasjeve në Maqedoni.....	23
3.2 Krimi i viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë....	25
3.3 Mosha e viktimave të vrasjeve në territorin e Maqedonisë	

	gjatë periudhës 2005-2015.....	26
3.4	Gjinia e viktimave të vrasjeve në Maqedoni gjatë periudhës 2005-2015.....	27
3.5	Mjetet dhe metodat e përdorura gjatë viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015.....	28
3.6	Viktimat e hakmarrjes dhe gjakmarrjes si formë e veçantë në Republikën e Maqedonisë.....	29
3.7	Kompensimi dhe mbrojtja e anëtarëve të familjeve të viktimave të vrasjes.....	30
3.8	Mjetet dhe motivet e vrasjeve.....	32

KAPITULLI I TRETË

	Mbrojtja dhe ndihma e viktimave të krimit.....	33
1.	Mbrojtja dhe ndihma e viktimave gjatë viktimizimit primar.....	33
2.	Marrja në pyetje dhe mbrojtja nga viktimizimi sekondar.....	34
3.	Informimi dhe njohja e viktimës me të drejtat e saj në procedurë.....	35
3.4	E drejta në respektimin e dinjitetit dhe integritetit moral dhe personal.....	35
3.5	E drejta e viktimës në mbrojtje profesionale.....	36
3.6	E drejta e viktimës në lëvizje të lirë.....	37
3.7	Të drejtat e viktimës	38
3.8	Të drejtat tjera të të dëmtuarit.....	40
3.9.	Të drejtat e viktimave dhe mbrojtja e tyre sipas parimeve bazë dhe aneksit të deklaratë së OKB-së të vitit 1985.....	41

KAPITULLI I KATËRT

Vështrimi mbi rastet veç e veç të viktimave të vrasjeve në territorin e Maqedonisë.....	43
1. Viktimat e krimeve të vrasjeve në qytetin e Tetovës.....	43
2. Viktimat e krimeve të vrasjeve në Shkup.....	45
3. Viktimat e krimeve të vrasjeve në territorin e Gostivarit.....	47
4. Përfundimi.....	48
5. Literatura.....	50

Hyrje

Edhe Maqedonia gjatë këtyre dekadave ka kaluar nëpër sfida të mëdha dhe të ndryshme, ndërsa së bashku me kalimin e këtyre sfidave ka pasur edhe viktimat e krimeve të vrasjeve. Jemi të vetëdijshëm se fjala është për një temë komplekse dhe të ndjejshe nga shkakut se kriminaliteti si dukuri negative ka përfshirë tërë botën. Fatkeqësisht as vendi ynë nuk është i përjashtuar nga ky lloj fenomeni. Në Maqedoni jemi dëshmitarë se gati të gjitha llojet e kriminalitetit janë prezentë, duke filluar nga ai me rrezikshmëri më të ulët e deri te ai me rrezikshmëri më të lartë. Përcaktimin tim për këtë problematikë mendoj se e arsyeton edhe vetë aktualiteti në vendin ku jetojmë, shqetësimi i shoqërisë, si dhe lufta kundër mbrojtës së viktimave të krimeve të vrasjeve, që është një problematikë mjaft serioze kur bisedohet në çështjen juridike-penale. Kjo dukuri pothuajse ka kapluar jo vetëm Maqedoninë si shtet, por edhe gjithë rruzullin tokësor. Veprat penale të vrasjes zënë vend të posaçëm në kriminalitetin e një shoqërie. Edhe Maqedonia pothuajse 10 vitet e fundit d.m.th prej vitit 2005 e deri në fundin e vitit 2015 në statistikën e policisë për viktimat e krimeve të vrasjeve thuhet se numri i kriminalitetit tregon rënie, ndërsa si arsye kryesore mendohet të jenë: papunësia, shkollimi, gjendja dhe pozita sociale e ekonomike, faktori mental, familja dhe shumë faktorë të tjerë që mendohet se çon në rritje numrin e viktimave të vrasjeve. Sipas studimeve kriminalistike dhe të viktimave në shumë vende të botës numri më i madh i viktimave është me pasoja të dhunës që shkaktojnë vdekjen e njeriut. Duke marrë parasysh mungesën e studimit të viktimave të vrasjeve, vendosa që të bëj një hulumtim shkencor mbi këtë fenomen, një hulumtim mjaft serioz në fushën juridiko-penale.

Arsyeshmëria e hulumtimit të viktimave të vrasjeve

Studimi dhe hulumtimi për viktimat e krimeve të vrasjeve ka rëndësi të shumanshme, respektivisht studimi dhe hulumtimi i karakteristikave të viktimave të vrasjeve.

Duke studiuar karakteristikat e viktimës ne mund të vijmë në përfundim se duhet hulumtuar sa viktimat janë vrarë në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2005 – 2015, sa viktimat kanë qenë të fajshëm ose shkaktarë të problemit dhe sa viktimat kanë qenë të pafajshëm. Viktimat e krimeve të vrasjeve si dukuri negative shoqërore janë të theksuara në të gjitha vendet e botës. Natyrisht që për këtë fenomen kërkon një angazhim të madh lidhur me trajtimin dhe hulumtimin nga ana e organeve shtetërore të vendeve përkatëse. Me hulumtimin profesional në një shtet mund të vijë deri te zvogëlimi i numrit ose i parandalimit të kriminalitetit. Hulumtimet profesionale nga ana e institucioneve të policisë mund të çojë deri te motivet e kryerjes së veprës penale, vrasjes, gjetja e kryerësit dhe padyshim edhe dënimi i paraparë në kodin penal. Me dënimin e autorëve të krimeve të vrasjeve, arrihet edhe qëllimi i parandalimit të veprave të tjera penale si vrasja në përgjithësi. Autori i njohur Falandysi shpjegon se viktimat e krimeve të vrasjeve në mënyrë profesionale më mirë janë zbardhur duke bërë hulumtime të viktimave dhe se ky është një kërkim shkencor i viktimave ku mund të bëhet studimi i të vrarit”. Siç dimë i vrari është produkt i vrasjes dhe nga personaliteti i viktimës mund të kuptojmë sidomos motivet e vrasjes, kapjen e autorëve dhe përcaktimin e sanksioneve. Këto janë të gjitha karakteristikat e viktimave të vrasjeve që janë hulumtuar gjatë këtij punimi shkencor dhe sidomos profesionalizmi për parandalimin e viktimave nga vrasjet, me ç’rast kërkon një fushë të gjerë hulumtuese ndaj atyre që kanë pësuar nga akti makabër kriminal.

Metodologjia e punës

Për realizimin e këtij punimi për master do të përdoren metoda të ndryshme për përmbledhjen dhe analizën e tij, që kanë të bëjnë me aspektin ligjor, i cili mundëson bashkëpunimin e institucioneve me sektorët e ndryshëm brenda shtetit dhe organizatave vendore e ndërkombëtare, dhe në cilat pengesa hasin këta institucione gjatë detyrës në zbatimin e ligjit. Metodologjia e hulumtimit të këtij punimi do të ngërthejë metodën krahasimtare. Përmes kësaj metode do të bëhen krahasimet e nivelit të krimit, të dhënat statistikore të cilat do të mblidhen dhe pasqyrohen përmes raporteve e statistikave përkatëse të organeve të rendit apo Policia ndhe nga ana e organeve gjyqësore. Metoda deskriptive, me përdorimin e të cilës do të vihet në pah lidhshmëria, bashkëpunimi dhe puna produktive e institucioneve policore të Maqedonisë. Metoda e analizës dhe sintezës do të verifikojë hipotezat e dhëna. Do të përdoret edhe metoda statistikore e analizës kuantitative të të dhënave përkatëse dhe interpretimi i tyre përmes metodës dogmatike në kontekstin rajonal në rrafshin e sigurisë në vendin e Republikës së Maqedonisë se sa ka bërë punën më profesionalizëm Policia e shtetit a është parandaluar krimi i vrasjeve ose është rit numri i viktimave të krimieve të vrasjeve. Gjithashtu me metodën krahasuese vlen të përdoret pasi me ndihmën e saj do të bëjmë krahasimin e viktimave të krimeve të vrasjeve sipas gjinisë nga viti në vit në Republikën e Maqedonisë si dhe me metodën statistikore me anë të së cilës do të jepen të dhëna statistikore për vitkimat e krimeve të vrasjeve në Republikën e Maqedonisë gjatë periudh 2005 – 2015 brenda 10 viteve.

KAPITULI I PARË

Vështrim i përgjithshëm mbi viktimat e krimeve të vrasjeve

1. Viktimat e krimeve të vrasjeve si lloj i veçantë i krimeve të dhunës

Me vrasje nënkuptojmë atë vepër të kundërligjshme, me anë të së cilës i meret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes ekzistojnë edhe vepra të kualifikuara dhe të privileguara të vrasjes, të cilat nga vepra themelore dallohen me disa rrethana shtesë, siç janë: mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rrethanat subjektive dhe të ngjashme.¹

Sipas kërkimeve të shumta viktimologjike dhe kriminologjike në të gjitha vendet e botës numrin më të madh të viktimave e përbëjnë ato që janë me pasoja të dhunës së vrasjeve që atakojnë jetën dhe trupin e njeriut. Pothuajse krimet e vrasjeve janë shumë të përhapura dhe si të tilla, kështu edhe rritet numri i madh i viktimave. Nocioni i dhunës sipas Organizatës së Shëndetësisë me selinë qendrore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është „përdorimi i qëllimshëm apo kërcënimi përmes forcës fizike kundër jetës së njeriut, kundër vetes, apo kundër një grupi shoqër. Nga kjo del se çdo forcë fizike që përdoret në menyrë të ndryshme si dhe me mjete të ndryshme kundër çdokujt po edhe kundër vetes quhet dhunë. Dhuna si veprim kriminal mund të veçohet në disa tipare, me veprime agresive, me detyrim të viktimës që të veprojë kundër vullnetit të lirë, me atakim dhe me rrezikim të jetës, me veprim ndaj shëndetit, me veprim kundër lirisë dhe të mirave të tjera të viktimës, pra si përfundim dhuna është përdorim i forcës së njeriut kundër njeriut apo kundër një grupi shoqëror me qëllim shkaktimi të dhunës fizike, psikike dhe morale të njeriut. Prandaj është shkruar shumë për këtë fenomen të kriminalitetit si vepra më të rënda. Që të parandalohen krimet e vrasjeve në vendin tonë duhet të punojë policia e Maqedonisë mënyrë më efikase. Ky institucion duhet të

¹ Dr. Ismail Zejneli-E drejta penale, pjesa e posaçme, Tetovë, 2007

angazhohet maksimalisht që të mos vijë deri te rritja e krimeve të vrasjeve për arsye se ky lloj i kriminalitetit njihet si njëri ndër krimet më të rënda në kodin penal të Maqedonisë.²

1.1. Nocioni për viktimat e krimeve të vrasjeve

Me viktimë të krimeve të vrasjeve nënkuptojmë marrjen e jetës së njeriut me mënyra të ndryshme të dhunshme, me metoda si dhe me mjete të ndryshme. Nga vetë nocioni mund të kuptojmë se viktimat shkaktohet nga mënyrat e dhunshme si vrasja apo marrja e jetës së njeriut. Ky lloj krimi hyn në kategorinë e krimeve të vrasjeve dhe se dënohet me kodin penal 123 të Republikës së Maqedonisë në të cilin thuhet : „ **Ai i cili do ta privojë tjetrin nga jeta, do të dënohet më së paku me 5 vjet burgim**”³ „ Vrasjet janë një nga shkaqet e vdekjes që shkaktohen në mënyrë të dhunshme. Vdekja e dhunshme apo (mors violent) është shuarja e jetës me dhunë. Shkaqet e dhunës mund të jenë mekanike, asfiksive – pengesë frymëmarrjeje , nutritive – mungesë ushqimi , fizike - që nënkupton veprimi i të nxehtit dhe të ftohtit, ndikimi i diellit dhe rrymës, klinike – kryesisht ndikimi i helmeve , bakteriale si dhe psikike. Kohëve të fundit në gjithë rruzullin tokësor, si edhe në territorin tonë, ky fenomen pothuajse duhet të parandalohet. Efikasiteti i punës së organeve shtetërore duhet të zhvillohet me profesionalizëm që ky fenomen të parandalohet, që të mos vijë deri te rritja e kriminalitetit. Vrasjet e fundit në Maqedoni, siç janë disa raste në territorin e Tetovës, gjithmonë këto vrasje janë shqetësuese dhe duhet të japin alarm për institucionet e sigurisë, por kjo nuk do të thotë që policia nuk ndërmerr masa. Këtu shqetësim parësor paraqesin armët pa leje që mund të posedojë çdo qytetar, ndërsa reagimi në kohë nga ana e policisë së shtetit mendohet se mund të ulën krimet e vrasjeve si:

- Kontrollat nga ana e policisë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare,
- Kontrollat apo bastisjet nëpër shtëpi , banesa , lokale,
- Kontrollat nëpër veturat e qytetarëve,
- Kontrollimi personal dhe profesional i qytetarëve.

² Ragip Halili „ Viktimologjia,, 2007 faqe.63

³Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – neni 123 Vrasjet
www.p r a v o . o r g . m k .

1.2 Kuptimi i viktimës dhe Viktimizimit

Fjala viktimë nënkupton personin ose grupin e caktuar që ka pësuar , që është dëmtuar. Pësimi apo viktimizimi ka të bëjë me privimin nga jeta, me dëmtimin e integritetit trupor , me shkatërimin e shëndetit fizik dhe mendor , me ngeljen me pasoja të rënda fizike dhe psikike afatshkurtëra ose afatgjata. Pësimi dhe dëmtimi nënkupton edhe shkatërimin e pasurisë dhe të të mirave tjera morale e materiale , shkeljen , cenimin dhe rrezikimin e të drejtave dhe lirive individuale e kolektive të njeriut. Vështuar nga ky aspekt nocioni viktimë përfshin një mori formash dhe gjendjesh të viktimave dhe te viktimizimit të njerzëve.⁴ Zakonisht si viktimë është njeriu dhe të drejtat e të mirat të tij , mirëpo sot flitet edhe për viktimën në kuptim më të gjërë të fjalës , ku si viktimë përfshihen edhe qeniet e botës shtazore dhe bimore. Në këtë punim do të trajtohen vetëm viktimat njerzore e jo edhe viktimat shtazore e bimore , po ashtu në trajtimin e kuptimit të viktimës do të shkohet nga qasja më e ngushtë e këtij fenomeni domethënë do të trajtohen vetëm llojet e viktimave të krimeve dhe problematika e viktimologjisë kriminale e jo të gjitha llojet e viktimave.⁵ Fjala viktimë rreth nga kuptimi i fjalës latine „ victima” dhe fjala vincere. Kuptimi i këtyre fjalëve është : flijim , sakrifikim , viktimizim , privim , pësim , dëmtim i jetës dhe trupit , cenim i lirive dhe të drejtave , shkatërim i pasurisë dhe të mirave tjera materiale e morale të njeriut. Dikur me fjalën viktimë apo flijim është kuptuar zakoni apo adeti i flijimit , i vetëflijimit i sakrifikimit , bërja kurban për qëllime dhe nevoja të idhujve , miteve , forcave të fuqive demone iracionale si dhe flijim për ideale familjare kombëtare , patriotike apo religjioze.⁶ Mirëpo sot kur flitet për viktimën viktimizimin menohet për një kuptim tjetër të të viktimës . Fjala është për viktimën e sjelljeve kriminale , për viktimën e luftërave , të katastrofave ekologjike dhe të dukurive tjera , të cilat janë rezultati veprimeve apo mosveprimeve tjera njerzore. Zakonisht pasojat e këtyre viktimave janë të mëdhaja dhe shprehen në humbjen e jetës në plagosjen dhe dëmtimin e shëndetit fizik dhe moral të milionave njerzëve në gjithë ruzullin tokësor , në shkaktimin e dëmeve materiale me miliarda euro dhe shumë pasoja të tjera të rrënda. Në lëminë kriminologjike dhe juridiko-penale si viktimë ose i dëmtuar , sikurse quhet viktimë në dispozitat e kodit të procedurës penale konsiderohet personi i cili nga veprimi kriminal ka pësuar cenimin , shkeljen apo rrezikimin e ndonjë të mirë a të drejtë personale.

⁴ Ragip Halili ,, Viktimologjia,, 2011 faqe.8.

⁵ Ragip Halili ,, Viktimologjia,, 2011 faqe. 9

⁶ Ragip Halili ,, Viktimologjia,, 2011 po aty.

1.3.Raporti në mes viktimës dhe kryerësit të vrasjes

Siç kemi thënë edhe më herët se pjesëmarrës gjatë ndonjë viktimizimi të ndonjë rasti mund të jenë dy subjekte që në literaturën juridike njihen si :

- Subjekti pasiv (viktima)
- Subjekti aktiv (kryerësi i viktimës)

Fenomeni i viktimave të krimeve kundër jetës dhe trupit , veçmas i krimeve të vrasjeve i ka nxitur shumë autorë të njohur që të merren me kërkimin dhe hulumtimin e disa veçorive të raporteve ndërmjet viktimës dhe shkaqeve të viktimizimit. Njëri ndër autorët e parë të studimeve viktimologjike , Benjamin Mendelsohn, ka qenë i mahnitur me njohuritë dhe përvojën nga praktika si avokat lidhur me raportin , kontributin si dhe rolin e viktimës në paraqitjen e krimit të vrasjes dhe të disa krimeve të tjera kundër individit. Ndërkaq, Hans V.Henting në veprën e tij „ Krimi dhe viktimat e tij,, konstaton se në shumë raste të vrasjeve viktima e përgatit dhe e gatuan vetë viktimizimin e saj. Autori slloven Janez Pecar , në hulumtimet e veta të krimeve të vrasjeve ne Slloveni ka ardhur në përfundim se në 51% të rasteve të vrasjeve , viktima me veprimet e veta fizike dhe gjestet verbale e ka nxitur viktimizimin e vet, në këtë menyrë ai flet për raportin interaktiv mes kryerësit dhe viktimës për sa i përket ndodhjes së krimit dhe viktimizimit. Ai thekson se nivelet e relacioneve të tyre janë prej qëndrimit pasiv dhe pa hile të vikimës, deri te nivelet e raporteve kur viktima mund të konsiderohet kryerës e jo viktimë. Pecar dallon dy lloje të raporteve të viktimave të vrasjes duke u nisur nga kontributi i tyre. Njëri raport është ai që është krijuar një kohë më të gjatë para kryerjes së vrasjes dhe tjetri i cili lind papritmas nga ndonjë konflikt aty për aty pa ndonjë ndërlidhje viktimogjene të mëparshme. Siç konstaton autori Pecar, në praktikë më shumë manifestohen rastet e para, që në praktikë ndodh që viktima të gjendet në pozitë pasive dhe indiferente, kur viktima nuk ka pasur kurrfarë kontakti dhe nuk është njohur më parë me kryerësin dhe ajo viktimizohet papritmas dhe aksidentalisht si dhe situatë kur viktima dhe kryerësi më parë janë njohur dhe kanë pasur raporte të ndryshme mes veti.⁷

⁷ Ragip Halili: „ Viktimologjia’’ 2011 Prishtinë , faqe: 66 , 67.

Në vazhdim do paraqesim një rastë të konfliktit të armatosur :

Rasti 1:

Dy të vdekur në një incident të armatosur në fshatin Merovë të Tetovës

Prokuroria Themelore Publike e Tetovës e ndriçoi vrasjen e ndodhur në fshatin Merovë. Në vendin e ngjarjes ka dalë edhe prokurori kompetent nga Prokuroria Publike e Tetovës, i cili e zhvillon hetimin për vrasjen e dyfishtë nga e cila dy persona kanë vdekur, dy vëllezër të moshës 23 dhe 25 vjeçare. Vrasja ka ndodhur në vendin Jabllanicë, f. Merovë, rajoni i Tetovës. “Sot në mëngjes në periudhën prej orës 6:00 deri në orën 7:00, ka ndodhur një përleshje midis dy grupeve të cilët janë në lidhje familjare. Në përleshjen midis tyre është përdorur edhe armë zjarri, me ç’rast nga jeta janë ndarë dy vëllezërit nga njëri grup, ndërsa plagë ka marrë babai i tyre. Nga ana tjetër janë plagosur dy persona të cilët me plagë trupore janë dërguar në Qendrën Klinike në Shkup”, theksohet në kumtesën e sotme të Prokurorisë. Hetimi i Prokurorisë Publike Themelore të Tetovës vazhdon në drejtim të përafrimit të dëshmimeve materiale me qëllim të ndriçimit të ngjarjes. Dy vëllezër nga fshati Merovë i Tetovës të moshës 24 dhe 25 vjeçare kanë marrë plagë vdekjeje nga armë zjarri pas incidentit të armatosur që sot në mëngjes rreth orës 7:00 ka ndodhur në vendin Jabllanicë në zonën e fshatit Merovë, përgjatë rrugës për në Sedllarevë, informoi zëdhënësi i SPB të Tetovës, Marjan Josifovski. Njëri prej vëllezërve ka vdekur në vendin e ngjarjes, përderisa tjetri në rrugë për në spitalin klinik të Tetovës. Dy persona të tjerë, të cilët morën pjesë në incidentin e armatosur, gjithashtu me plagë nga armë zjarri, pas ndihmës së dhënë në spitalin klinik të Tetovës, janë dërguar në Klinikat e Shkupit. Në vijim po kryhet ekspertiza në të cilën merr pjesë prokurori publik dhe ekipi i SPB të Tetovës rreth konfirmimit të arsyeve dhe gjithçka lidhur me rastin.⁸

1.4. Klasifikimi dhe tipologjia e viktimave

Për studimet viktimologjike është shumë me rëndësi të analizohet shumë dhe të njihen edhe tipat dhe llojet e viktimave që shfaqen më së shpeshti. Në këtë aspekt veçmas bëhen përpjekje që të zbardhen edhe raportet në mes kryerësit dhe viktimës. Autorët e njohur të kriminologjisë dhe të

⁸ www.portalb.mk 07/ 05/ 2015.

viktimilogjisë kanë arritur në përfundim se për të ekzistuar krimi duhet të ketë më së paku dy protagonistë :

- kryerësin dhe
- viktimën.

Kërkimet e ndryshme mbi viktimat tregojnë se midis kryerësit dhe viktimës në të shumtën e rasteve apo formave viktimizuese ekzistojnë relacione dhe raporte të ndryshme qysh para rastit viktimizues. Varësisht nga rastet, midis kryerësit dhe viktimës kemi disa klasifikime apo ndarje të viktimave sipas autorëve të njohur.

Autori Shëind citon një thënie të Naigelit lidhur me tipat e viktimave ku midis tjerash edhe konstaton : “ Ushtarët e dobët në përlëshjet ushtarake bëhen lehtë viktimë e atyre më të fuqishmëve , po ashtu edhe qytetarët apo individët e dobët, fëmijët , pleqtë , të sëmurët e ndryshëm viktimizohen më shumë se kategoria tjetër e popullatës⁹ ,,

1. Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas Z. Shepareviq:

Sipas mendimit të profesorit kroat të viktimilogjisë , Dr.Z. Shepareviq të prezantuara në veprën e tij Viktimologjia dhe të mbështetura në studime të shumta të autorëve eminentë botërorë , ekzistojnë disa tipa të viktimave:

- viktimë vullnetare,
- viktimë e panjohur,
- viktimë e pavëmendshme ,
- viktimë simuluese,
- viktimë e mbetur në tentativë.

Viktimë vullnetare ose viktimë me vetëdëshirë është një tip i veçantë i viktimave të cilat vetë kërkojnë ose pajtohen të bëhen viktimë. Këto viktimë nuk i detyron askush që të viktimizohen. Për këto viktimë thuhet se me vullnet të lirë dhe me bindje e krijojnë vetë dhe i nënshtrohen viktimizimit dhe pajtohen që të jenë viktimë.

⁹ Ragip Halili : „ Viktimologjia “ 2011 Prishtinë faqe:54,55,po aty.

Viktima e panjohur është një tip tjetër i rastit viktimizues , që ka të bëjë me viktimat të cilat kanë pësuar nga ndonjë veprim kriminal apo në ndonjë mënyrë tjetër, por rasti nuk është paraqitur dhe nuk është evidentuar në organet kompetente apo shoqatat dhe organizatat joqeveritare. Viktima edhe pse ka pësuar, ajo nuk e paraqet rastin në polici , prokurori apo gjykatë, ndërsa si përfundim këtu kemi të bëjmë me „ numrin e errët’’ të viktimave.

Viktima e pavëmendshme është një tip i viktimave të cilat në jetë pësojnë ngase nga veprimet, sjelljet, raportet me të tjerët janë të pavëmendshëm. Kontaktet dhe relacionet e ndryshme në jetën e përditshme i ndërmarrin me mendjelehtësi , viktimat e tilla lidhur me sigurinë fizike , me shëndetin e vet, me sigurinë e pasurisë dhe me të mirat e tjera shpesh sillen në menyrë të papërgjegjshme.¹⁰

Viktima simuluese është viktimë e shpifur apo viktimë e rrejshme. Është lloj i veçantë i viktimave të cilat në realitet nuk kanë pësuar, por shtiren në mënyrë artificiale se gjoja kanë pësuar dhe shpeshherë akuzojnë dhe fajësojnë të tjerët për viktimizim apo për shkaktim të dëmeve të ndryshme. Këto lloj viktimash shpeshherë në jetën e përditshme paraqiten si denoncues , bëjnë kallzime penale, akuzojnë rrejshëm, shpifin , si dhe paraqiten si dëshmitarë etj. Viktima e mbetur në tentativë ose viktima që ka dashur të bëhet viktimë , është një tip i veçantë. Këtu viktima edhe pse është planifikuar të bëhet viktimë e krimeve të vrasjeve, nuk është bërë dot viktimë e krimeve të vrasjeve, por nga vetë fakti i tentimit për t’u viktimizuar asaj mund t’i shkaktojë problem të natyrës psikike, po edhe fizike .¹¹

2. Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas H.V. Hentingut:

Lidhur me tipologjinë dhe klasifikimin e viktimave do t’i paraqesim edhe disa ndarje të cilat i kanë bërë autorët e studimeve viktimologjike më herët apo kohëve të fundit. Siç është thënë më herët, si nismëtar i studimeve viktimologjike konsiderohet Hans V. Henting me veprën e vet

¹⁰ Z.Shepareviç vepra e cituar faqe: 10-14.

¹¹ Ragip Halili: „ Viktimologjia’’ 2011 Prishtinë , faqe: 56.

Krimi dhe viktimat e tij. Përveç tjerash Hentigu konstaton se viktimat mund të ndahet sipas shkaqeve të viktimizimit në dy grupe personash, në grupin e personave që më tepër pësojnë për arsye të ndikimeve të faktorëve psiko-bilogjikë ose siç mund të trajtohen si viktimat e lindura dhe në grupin tjetër, në persona që pësojnë më tepër për shkak të ndikimeve të faktorëve sekondare të natyrës sociologjike, pra nga ndikimet e ambientit social. Duke marrë parasysh kontributin e viktimës, H.V.Hentingu i ndan në viktimat e krimit dhe në viktimat potenciale apo latente. Përveç kësaj ndarjeje Hentingu përmend edhe 13 lloje të tjera të viktimave si: viktimat e reja, viktimat femra, viktimat pleq apo të moshuar, viktimat të sëmurë mentalisht, viktimat emigrant, viktimat pakica nacionale apo grupe etnike, raciale, fetare, viktimat me depresione , viktimat shpirtërore , viktimat të papërgjegjshme , viktimat të vetmuara , viktimat të trishtuara , viktimat të martirizuara dhe viktimat të dëshpëruara.¹²

3. Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas Mendelsonit:

Autori tjetër i studimeve të para viktimologjike Benjamin Mendelson bën dallimin e dy llojeve të viktimave. Mendelsoni viktimat i ndan në dy lloje:

- në viktimat e krimit dhe
- në viktimat që bëhen si të tilla , për shkak të vetekspozimit.

Mendelsoni viktimat e krimit sipas pjesëmarrjes në viktimizim apo në pësim i ndan në:

- Viktimat tërësisht të pafajshme të cilat pësojnë pa fajin e tyre, që nuk kontribuojnë në asnjë mënyrë për viktimizimin e vet. Këto viktimat rëndom janë të paafta që të provokojnë ose të mbrohen , prandaj edhe pësojnë. Të tilla viktimat konsiderohen fëmijët e sapolindur , foshnjat si dhe fëmijët e vegjël.
- Viktimat pjesërisht të fajshme të cilat pësojnë më tepër për shkak të gjendjes në të cilën ndodhen e jo për shkak të ndonjë motivi tjetër, ndërsa në literaturë si raste të tilla përmenden femrat shtatzëna që i nënshtrohen abortit apo ndërprerjes së shtatzënisë.
- Viktimat fajtoresh sa edhe vetë viktimizuesit janë persona që në masë të madhe kanë kontribuar për ndodhjen e rastit viktimizues. Në këto raste vetëm rethanat e çastit kanë

¹² Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 57.

ndikuar që viktima të pësojë e jo kryerësi i krimit , sepse edhe ajo me sjelljet dhe veprimet e veta ka kontribuar sa edhe vetë kryerësi në viktimizim si p.sh. plagosja apo pësimi gjatë rahjes , gjatë kacafytjes etj.

- Viktima provokuese është një tip viktime që shpeshherë është më fajtor se sa kryerësi i krimit. Ajo viktimë me sjelljet, me gjestet apo veprimet e veta kontribuon në krijimin e rrethanave të cilat e viktimizojnë.
- Viktima vet fajtor është lloj viktime që vet e inicon konfliktin dhe situatën e rrezikshme, por për shkak të rrethanave të ndryshme ajo viktimizohet vetë. Në literaturën viktimologjike si raste të këtij lloji të viktimës merret viktimizimi nga mbrojtja e nevojshme , kur viktima e planifikuar për viktimë bëhet kryerës , ndërsa kryerësi bëhet viktimë.

4. Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas E.A. Fattahut:

Autori tjetër me famë botërore në lëmin e kërkimeve viktimologjike Ezat A Fattah bën përafërsisht një klasifikim të ngjashëm. Fattah viktimat i ndan në këtë mënyrë:

- Viktima që nuk merr pjesë gjatë viktimizimit, pra fjala është për viktimën që nuk është e pranishme ndërsa pasojat e krimit dhe të viktimizimit dalin më vonë.
- Viktima abstrakte, është viktima pa emër dhe jo specifike.
- Viktima sprovuese , është viktima e cila e sprovon kryerësin p.sh. të dhënia e parave me interes , me fajde ku lakmia , pangopësia dhe interesi material apo ndonjë interes tjetër është faktor që shkakton viktimizimin¹³.
- Viktima që e lut kryerësin që ta viktimizojë janë raste të eutanazisë etj.
- Viktima provokuese, e cila me sjelljet dhe veprimet e veta e nxit dhe provokon kryerësin për çka edhe ajo vetë pëson.

5. Klasifikimi apo tipologjia e viktimave sipas H.D.Shëindit:

Kriminologu gjerman Shëind duke komentuar tipologjinë e Hentingut mbi viktimat ai viktimat i klasifikon në këto tipa të viktimave :

¹³ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 58.

- Viktima të situatës. Këto viktima bien viktimë të situatave të caktuara si p.sh. të mashtrimeve për martesë.
- Viktima me raporte familjare, si mbytja e fëmijës , incesti , vrasja e prindërve , vrasja e burit, si dhe vrasja e gruas.
- Viktima për shkak të profesionit apo mjeshtërisë, si postieri , shoferi , taksisti , prostituta dhe lypësi etj.
- Viktima për shkak të lakmisë dhe përfitimit material, si pasurimi, p.sh. mashtrimet në bursë , dhënia e parave me fajde , lidhja e kontratave me kamatë të lartë etj.
- Viktima për shkak të përkatësisë sociale, etnike , fetare , raciale , minoritarë të huaj etj.
- Viktima për shkak të gjendjes së veçantë biofizike dhe biopsikike. Këto viktima janë si p.sh. fëmijë, pleq të sëmurë mendorë , alkoolistë, invalidë dhe persona me të meta të ndryshme trupore.
- Viktima të rastit janë ato viktima si p.sh. udhëtarë aeroplani , autobusi, treni, anijeje, viktima kidnapimesh dhe rrëmbime të udhëtarëve , viktima pengmarrjesh gjatë plaçkitjeve të bankave apo qendrave tregtare apo marketeve.¹⁴

1.5. Kategoritë dhe faktorët e rrezikut

Që në kërkimet e mëhershme mbi krimin dhe viktimat e krimeve të vrasjeve ka pasur shumë debate dhe mendime të ndryshme mbi faktin se për çfarë disa individë bëhen kriminelë , kryerës, ndërsa disa të tjerë bëhen viktima apo pësojnë. Në jetën e përditshme edhe sot ka mendime se rastet e pësimit dhe viktimizimit janë të paparashikuara, se ata ndodhin nga vullneti i ndonjë fuqie më të madhe, sepse „ **ashtu qenka shkruar** “. Këto rrethana, kategori apo faktorë të rrezikut në literaturën viktimologjike emërtohen edhe si një lloj paradispozicioni viktimogjen. Fjala është për disa veti , cilësi, shenja dhe rrethana të cilat luajnë rol vendimtar në viktimizimin e personave të caktuar. Prandaj në këtë drejtim është sajuar edhe kuptimi dhe nocioni i një viktime të veçantë, e cila quhet **viktimë latente**. Disa autorë të tjerë këto rrethana dhe faktorë të rrezikut i vlerësojnë si rrethana personale dhe të përgjithshme, si rrethana personale zakonisht përmenden vetitë biopsikike si :

¹⁴ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 61.

- mosha
- gjinia
- inferioriteti fizik
- invadiliteti
- sëmundja psikike
- alkooli dhe droga.

Edhe vetitë dhe komponentët socialë të rrezikut gjithashtu mund të jenë të llojllojshme Pa dashur të futemi në shpjegime të hollësishme të këtyre faktorëve në vijim do të paraqiten disa nga ata të cilët më së shpeshti përmenden në literaturën viktimologjike që si të tilla numërohen:

- mosha dhe gjinia,
- gjendja martesore , statusi familjar,
- të divorcuarit , jetimët dhe të strehuarit në qendra azili,
- gjendja dhe pozita sociale ekonomike,
- profesioni dhe mjeshtëria,
- të papunësuarit dhe skamnorët,
- gjendja shëndetësore , sëmundjet kronike dhe sëmundjet e rënda,
- deviacionet dhe hendikepët fizikë,
- pakicat etnike , relegjioze dhe raciale,
- të huajt, emigrantët, azilantët,
- brezhësit dhe lypësit,
- alkoolistët dhe narkomanët,
- homoseksualët , tranvestitë dhe prostitutat,
- konfliktet etnike , fetare dhe politike,
- aksionet terroriste, mjetet eksplozive, autobombat dhe vetëvrarësit kamikazë me eksploziv,
- aksidentet në trafikun rrugor,
- fatkeqësitë natyrore , vërshimet, tërmetet dhe përmytjet,
- sëmundjet epidemike AIDS-i,

- avaritë në objekte që prodhojnë helme apo llojra radioaktiv , jonizues atomik ,
- katastrofat ekologjike , ndotja e ujërave , zjarret në pyje , efektet serë dhe rreziku global për shëndetin e banorëve ,
- të arrestuarit , paraburgosërit , të burgosërit ,
- pengjet e luftëtarëve dhe konflikteve lokale , të zënat robër lufte , të plagosurit dhe të sëmurët gjatë luftimeve luftarake dhe shumë kategori të njerzëve që pësojnë në rrethana të tilla , janë kategori e rrezikuar.

Me siguri kemi edhe shumë faktorë të tjerë të rrezikut që të përmenden, mirëpo këto faktorë janë më të rrëndësishëm në rastin e trajtimit dhe elaborimit të formave të ndryshme të viktimave dhe rrethanave viktimogjene të viktimizimit.¹⁵

1.6 Studimet mbi viktimat

Sipas kësaj metode , ose studimi mbi viktimat bëhet anketim dhe intervistim i personave të ndryshëm , për faktin se a kanë qenë ndonjëherë viktimë e krimeve të caktuara dhe a i kanë paraqitur ato në organet e policisë apo në gjykatë. Në literaturën kriminologjike si nismëtar i kësaj metode konsiderohet kriminologu i njohur H.Henting. Kjo metodë aplikohet në SHBA , Holandë , Kanadë , Itali etj. Të dhënat e fituara në bazë të studimeve të viktimave flasin se një numër i krimeve dhe i sjelljeve tjera kriminale është shumë më i madh se sa tregojnë statistikat kriminale zyrtare. Nga shënimet e mbledhura me anë të kësaj metode del se shumë të anketuar dhe të intervistuar ose të afërmit e tyre , kanë qenë viktimë e krimeve të llojllojshme e vecmas të dhunimeve seksuale , tentim dhunim , abuzimi seksual , maltretimeve dhe torturimeve në familje nga prindi ose nga kujdestari , keqtrajtimet në shkollë , në vendin e punës , krime të vjedhjeve të zakonshme , vjedhjet e imta , krime të kërcënimeve , shpifjeve , fyerjeve si dhe disa krime të tjera kriminale.¹⁶ Këto krime i kanë kryer kryers të njohur dhe të panjohur , arsyet e mosparaqitjes dhe mosdenoncimit ne organet shtetore si policia dhe organet tjera kompetente janë të shumta si në vijim: *konsiderimi i tyre si krime të imta dhe pa pasoja , lidhja familjare fafeshnore me kryersin , varshmëria materiale dhe statusi i pozitës nënshtruese në punë e afarizëm nga kryersi ose të afërmit e tyre , dyshimi në aftësinë e*

¹⁵ Ragip Halili: „ Viktimilogjia” 2011 Prishtinë , faqe: 62-63.

¹⁶ Ragip Halili „ Kriminologjia” Prishtinë , 2011 fq. 59.

policisë dhe efikasitetin e organeve të jurisprudencës për dënimin e kryerësve , frika nga hakmarrja , ruatja e fshetësisë familjare , frika nga gjykimi i opinionit , frika nga paraqitja e aferave , frika nga publikimi i çështjeve intime në shtyp dhe dalja e tyre në opinion dhe arsye të tjera. Këto dhe konstatime të tjera , vërtetojnë se kriminaliteti e sidomos disa krime janë shumë prezente në jetën e përditshme se sa tregojnë statistikat zyrtare shtetërore të policisë apo organeve gjyqësore.

KAPITULI I DYTË

2. Marrja e jetës si vepër penale

Çdo shtet në botën bashkëkohore ka të rregulluar në kodin penal mbrojtjen e jetës së qytetarit të vet. Këto mbrojtje janë të inkriminuara si vepra penale në legjislacionin e tyre kombëtar, por edhe shteti ynë, Maqedonia, e ka të rregulluar përmes legjislacionit të vet që pas pavarësisë quhet Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, që ka hyrë në fuqi pas një viti.

Në kapitullin XIV në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë parashihen veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe se me këto vepra nënkuptojmë vepra penale me të cilat personi privohet nga jeta apo i shkaktohet lëndim trupor , ndërsa në nenin 123 të Kodit Penal të Maqedonisë veprat penale të vrasjes janë:

1. Vrasja
2. Vrasja nga motive fisnike
3. Vrasja në çast
4. Vrasja nga pakujdesia
5. Vrasja e fëmijës gjatë lindjes.

Nga të gjitha këto vrasje lindin viktimat e vrasjeve si dhe klasifikimi është bërë për lartësinë e dënimit të kryerësit dhe për klasifikimin e viktimave se në çfarë lloj vrasje është viktimizuar personi. Me tërë këtë nënkuptojmë vepër penale të kundërligjshme me anë të së cilës merret jeta e një personi tjetër pa marrë parasysh me dashje ose nga pakujdesia, si dhe se objekti është jeta e njeriut, kurse subjekti i veprës është çdo person që ka përgjegjësinë penale, ndërsa nga ana subjektive krimi mund të kryhet në dy faza me dashje direkte ose indirekte apo nga pakujdesia.¹⁷

Vrasja nga pakujdesia paraqet një rrezikshmëri shoqërore më të vogël në krahasim me vrasjet e kryera me dashje.¹⁸ Vrasja nga pakujdesia konsiderohet se është kryer nëse dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryerësit të veprës penale. Te vrasja nga pakujdesia

¹⁷ Afrim Osmani Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë botimi 2010 neni 123 fq 129 .

¹⁸ Dr.Ismail Zejneli, E drejta penale, pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq.25

privimi i ndonjë personi nga jeta manifestohet në mënyrë specifike, zakonisht këtu bëhet fjalë për veprime të cilat janë ndërmarrë për qëllim tjetër e jo për qëllim të privimit të ndonjë personi nga jeta.

2.1.Vështrimi viktimologjik mbi viktimat e krimeve të vrasjeve në Maqedoni

2.2.Viktimat e krimeve të vrasjeve në Maqedoni gjatë periudhës 2005-2015

Në territorin e Maqedonisë respektivisht nga viti 2005 deri në vitin 2015 sipas të dhënave statistikore të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë kanë ndodhur gjithsej 381 vrasje. Më poshtë do të paraqesim tabelën për vrasjet në Maqedoni sipas të dhënave të siguruar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë.

Tabela 1

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Vrasjet e kryera	53	51	42	36	36	40	29	28	20	25	21

Gjithsej vrasjet sipas raporteve të policisë në Republikën e Maqedonisë nga viti 2005 deri në vitin 2015	381
---	------------

Në bazë të dhënave dhe numrave të nxjerrë nga arkivi i policisë së Maqedonisë, duket se nga viti 2005 e deri në vitin 2015 gjithsej kemi 381 vrasje në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë pa dallim moshe , gjinie , race , feje apo kombi .

Në tabelën e mësipërme vërehet se kemi ulje drastike në kriminalitetin e krimeve të vrasjeve nga viti 2011 e deri në vitin 2015.¹⁹

Tabela numër 2

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Viktimat e vrasjeve	53	51	41	36	46	41	32	29	22	33	25

Gjithsej viktimat e krimeve të vrasjeve sipas raporteve të policisë në Republikën e Maqedonisë nga viti 2005 deri në vitin 2015	409
--	------------

Në tabelën numër 2 kemi paraqitur po ashtu disa të dhëna statistikore të marra nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, gjegjësisht Arkivit policor. Në këtë tabelë shihen numrat e viktimave të krimeve të vrasjeve nga viti 2005 e deri në vitin 2015 të ndara për çdo vit në territorin e Republikës së Maqedonisë. Nga kjo tabelë konstatohet se gjithsej viktimat e krimeve të vrasjeve në Republikën e Maqedonisë nga viti 2005 e deri në vitin 2015 kemi gjithsej sipas raporteve apo sipas tabelës sic e kemi theksuar më lartë është gjithsej 409 viktima të krimeve të vrasjeve në vendin tonë. Në vitin 2005 krahasuar me vitet paraprake ka pasur më shumë vrasje numri i së cilës ka aritur deri në 53 viktima të krimeve të vrasjeve, ndërsa ulje të vrasjeve nga të dhënat që i kemi ka pasur në vitin 2013 këtu janë ulur vrasjet krahasuar me vitet tjera.²⁰

¹⁹ Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Shkup 29.12.2016
Byroja për Siguri Publike
Kërkesa apo akti numër: 22.80239/1
Numri Arkivor i Policisë 22.4-5209/2.

²⁰ Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Shkup 29.12.2016
Byroja për Siguri Publike
Kërkesa apo akti numër: 22.80239/1
Numri Arkivor i Policisë 22.4-5209/2.

2.3. Karakteristikat e krimeve të vrasjeve në territorin e Maqedonisë nga viti 2005-2015

Kriminaliteti, si dukuri mjaft komplekse, paraqet një fenomen që kërkon një angazhim të veçant në hulumtimin dhe studimin e tij. Në këtë drejtim, veçmas shtrohet nevoja e studimit dhe analizës së vëllimit të tij në një shoqëri. Me vëllim nënkuptojmë aspektin kuantitativ të përhapjes dhe pranisë së krimit në shoqëri të ndryshme.²¹

Në këtë punim shkencor, qëllimi kryesor është hulumtimi i viktimave të krimeve të vrasjeve në Maqedoni si faktor kryesor, metodat e përdorura të viktimave të krimeve të vrasjeve në territorin e Maqedonisë. Si karakteristikë të siguruara për viktimat e krimeve të vrasjeve në territorin e Maqedonisë i kemi theksuar disa më të rrëndësishme që prej tyre janë:

- motivet e viktimizimit,
- mosha e viktimave,
- gjinia e viktimave ,
- mjetet dhe metodat e përdorura gjatë viktimizimit.

Këto karakteristika mendohet se më shpesh janë si faktorë kryesorë në viktimat e krimeve të vrasjeve apo në privimin e kundërligjshëm të viktimave të krimeve të vrasjeve. Po ashtu në informatat e marra nga punonjësit e Sektorit të Punëve të Brendshme në Tetovë si karakteristikë themelore në kriminalitetin e vrasjeve theksohet se motivet dhe mosha më së shumti ndikojnë në krimet e vrasjeve²².

2.4. Motivët e viktimizimit të vrasjeve në Maqedoni

Motivët janë veti dhe cilësi psikike që së bashku me karakterin , temperamentin, emocionet dhe shprehitë e formojnë dhe karakterizojnë individin dhe personalitetin e njeriut. Motivët si veti të personalitetit përbëhen prej elementeve të vetëdijes dhe vullnetit. Nga kjo del se nxitja , dëshira dhe nevoja e brendshme të quhen motive , pra motivi qenka shtytja e brendshme , nxitja , shkaku

²¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, faqe 115

²² Ragip Halili: „, Kriminologjia „, 2005 faqe.325.

dhe arsyeja e cila vepron në karakterin, epshin, ndjenjat, vizionet dhe pikëpamjet ndaj shoqërisë dhe botës në tërë personalitetin e njeriut.

Në disa figura të veprave penale , motivi dhe qëllimi janë elemente të domosdoshëm të anës subjektive të veprës penale që kryhet me dashje , në disa prej tyre janë si rrethana cilësuese , në disa të tjera si rrethana rënduese dhe në disa të tjera si rrethana lehtësuese , madje motivi dhe qëllimi kanë rëndësi shumë të madhe në matjen e dënimit nga gjykata, por motivi që e fut personin në gjëmën e fundit për të shuar nga jeta personin tjetër apo t'i merret jeta nuk është i vetmi faktor i cili ndikon në kualifikimin e veprës penale. Nga praktika kriminalistike motivet më të shpeshta për kryerjen e veprave penale janë: motivet ekonomike , urrejtja apo hakmarrja , motivet seksuale e erotike , frika nga dënimi , dashuria si dhe shumë motive të tjera fisnike. Në Gjykatën Themelore në Tetovë, respektivisht gjyqtari S.I. kishte udhëhequr rastin, veprën penale me motive dashurie të djaloshtit nga Tetova dhe viktimës së vrarë, vajzës nga Tetova dhe më udhëzoi që ta marr nga interneti materialin. Më poshtë do ta shihni ngjarjen e 28 prillit të vitit 2014 që pothuajse tronditi regjionin. Fjala është për një vrasje me motive dashurie:

Në vijim do të paraqesim ngjarjen me motive dashurie

Rasti 2 :

Kush ishin djali dhe vajza nga vrasja para VERO-s në Tetovë?

Të shtënat e armës së zjarrit tronditën edhe një herë tetovarët në pasditen e 28 prillit. Ekipet e policisë dhe ndihmës së shpejtë shkuan menjëherë në parkingun e marketit Vero për të marrë 20 vjeçaren me iniciale R.D nga fshati Jazhincë e cila kishte marrë plagë të rënda në krahator prej armës së zjarrit. Menjëherë u dërgua në spitalin klinik të Tetovës e Shkupit, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve dhe ndërroi jetë. Disa orë më vonë pjesëtarët e MPB-së arrestuan 26 vjeçarin H.S nga fshati Xhepçisht si të dyshuar për këtë akt. Histori dashurie që shkoj keq.. Portalb kontaktoi me shokë e familjarë për të sjellë detaje nga kjo ngjarje tragjike, gjithsesi duke pasur respekt për dhimbjen e familjeve R.D dhe H.S. Një lidhje e pasuksesshme dashurie disa mujore ka qenë arsyeja kryesore pse 26 vjeçari në fjalë ka shtënë mbi të dashurën e tij 6 vite më të re. Portalb mëson se H.S nuk ka mundur ta përballojë e as ta pranojë ndarjen me R.D. Ai kishte vendosur të hënën të hakmerret në mënyrën më të keqe të mundshme. Duke mos i treguar

asnjë personi për planin e tij, ai gjen pistoletën për të cilën policia ende konfirmon nga e ka marrë dhe rreth orës 16 shkon në vendin ku priten furgonët për të shkuar në fshatin e Resmijes për ta gjetur atë. Dëshmitarët dëshirojnë të mbeten anonimë, thonë se ka pasur një zënkë të shkurtër mes tyre deri sa Sejdiu ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar atë me dy plumba. Rrëmuje në mes të ditës ka shkaktuar akti i tij. Resmija pa ndjenja fanitet në tokë, ndërsa ai merr veturën e tij dhe largohet në drejtim të Shkupit. Me gjasë i hutuar nga vepra e tij, ai tenton të bëjë vetëvrasje me po të njëjtën pistoletë, por ndalohet nga policia e cila në atë çast e ka bindur që tani më ish e dashura e tij është mirë dhe do të kalojë lehtë nga lëndimet e marra. Ai tani është në paraburgim. Bashkëfshatarët e tij për portalb thonë se ai ishte një djalë i urtë dhe deri më tani nuk ka shkaktuar ndonjë incident. Familjet ende në shok, nuk deshën të prononcohen për këtë rast. Shqipmedia hulumtoi profilet e të lartpërmendurve në facebook dhe gjeti fotot e tyre, po edhe atë se çka kanë postuar në facebook, ku nëpërmjet fotove më poshtë do të shikoni vetë. Siç duket R.D me këngën e Medës – Ai plumb të postuar në facebook të saj para disa ditësh ka parandjerë vdekjen e saj, ndërsa në facebook të H.S vërehet një gjendje e rënde emocionale siç duket nga ndarja me R.D dhe vazhdimisht ka postuar këngë vajtuese, dëshpëruese, të cilat ia ka dedikuar pikërisht asaj. Më poshtë do të ndiqni postimet në rrjetin social facebook ku kanë shprehur parandjenjat e para si dhe vendi i ngjarjes se ku ka ndodhur vrasja.

Figura numër 1

Në figurën numër 1 mund të shihet vendi i ngjarjes ku u qëllua viktima me inicialet R.D nga i dashuri i saj me inicialet H.S në pasditën e 28 prillit të vitit 2014 pranë supermarketit Vero në Tetovë, ku me pistoletë u qëllua R.D , e cila ndërroi jetë në Klinikën e Kirurgjisë në Shkup. Fotografia e mëposhtme tregon vendin e ngjarjes ku u qëllua viktima.



Vrasja me motive dashurie ka ndodhur në Tetovë më 28.04.2014 pranë supermarketit Vero në Tetovë.²³

2.5. Krimi i viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë

Krimi i viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë pothuajse është një fenomen shumë i rëndësishëm që ka kapluar jo vetëm territorin e Maqedonisë, por pothuajse gjithë botën në përmasa të mëdha, ndërsa ky lloj kriminaliteti luftohet në përmasa të mëdha që të parandalohet. Viktimizimi sipas disa përkufizimeve më të zakonshme ndodh atëherë kur e trajton keq dhe me mënyra më armiqësore një person tjetër dhe kjo tregon një shembull të pastër të viktimizimit. Viktimizi mund të ushtrohet ndaj një personi, grup personash ose një popullsie. Si rast më të freskët e kemi rastin e Kumanovës në Lagjen e Trimave. Këtu më 09.05.2015 pati viktimizim në përmasa të mëdha. Në gazetën ditore të Maqedonisë në ballinën e saj dolën me bilancin tragjik të kësaj ngjarjeje, me 22 viktima. Viktimizimet ndahen në dy kategori :

- viktimizi primar dhe
- viktimizi sekondar.
- Viktimizi primar u referohet eksperiencave të viktimave për krime që janë kryer kundër tyre. Që këto eksperiencave të trajtohen në mënyrë të plotë, duhet të mblidhen dokumente të zgjeruara mbi natyrën e krimin, incidencën e përsëritjes së viktimizimit, ndikimi që krimi ka pasur mbi viktimin e vrasjeve si dhe frikën nga krimi i vrasjeve. Viktimizimi sekondar i referohet trajtimit që viktima merr nga institucionet e drejtësisë penale siç janë policia, prokuroria dhe gjykatat.

²³ <http://ilirida.net/kush-ishin-djali-dhe-vajza-nga-vrasja-para-vero-s-ne-tetove/>

2.6. Mosha e viktimave të vrasjeve në territorin e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015

Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këteleja (Quetele) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca më e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intensitetin e forcës fizike dhe pasionin e personit²⁴. Në përgjithësi është pranuar se në vendet ku ka probleme të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, të mungesës së rendit dhe të stabilitetit politik dhe ekonomik, mundësitë e përfshirjes në krim në mosha të hershme janë të mëdha²⁵.

Mosha e viktimave të vrasjeve përafërsisht përputhet me moshën e kryerësve të tyre. Në studimet empirike të krimit të vrasjeve të bëra në shumë vende del se si viktimë më të shpeshta paraqiten personat mes moshës 20 dhe 45 vjeç. Mirëpo, ka edhe mendime të tjera në këtë drejtim të cilët konstatojnë se edhe grupmoshat më të reja dhe ato më të vjetra, në raste të caktuara, janë mjaft të pranishme. Kjo është e kuptueshme ngase kjo kategori e grupmoshave është edhe më e pranishme në rjedhat e jetës së përdishme dhe njëherësh më e rrezikuar nga sulmet e llojllojshme të krimeve. Fëmijët dhe të miturit bëhen viktimë të vrasjeve më rrallë, ndërsa kur viktimizohen kjo ndodh si shkak i paafësisë së tyre që vetë të mbrohen dhe të kujdesen për vetveten. Në këtë drejtim, në praktikë dhe në literaturë, konstatohet se më tepër si viktimë paraqiten fëmijët jashtë martesës, fëmijët dhe foshnjat e sapolindura e sidomos ato që lindin dhe që rjedhin nga kontakte të parregulluara martesore, nga inceste, nga dashuri të ndaluara dhe të fshehta, nga raste të dhunimeve seksuale apo nga kontakte të tjera të padëshiruara. Po ashtu si viktimë paraqiten edhe fëmijët e lënë nën përkujdesje të personave të tjerë si njerëz apo njerëz nën kujdesin e alkoolistëve, narkomanëve, personave me çrregullime mendore apo personave të paafë.

Viktimizimi i fëmijëve ndodh edhe për arsye të lënies pas dore dhe moskujdesit ndaj kontaktit me mjete dhe gjësende të rrezikshme si :

- kontakti me armë zjarri,
- kontakti me helme të ndryshme,

²⁴ Dr. I.Yejneli, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, faqe 112;; veper e cituar

²⁵ Po aty;

- kontakti me barna apo materie të tjera toksike.²⁶

2.7.Gjinia e viktimave të vrasjeve në Maqedoni gjatë periudhës 2005-2015

Studimi i autorëve të veprave penale dhe vëmendja e kriminologëve ka ngjallur interesim dhe është drejtuar në studimin e lidhjeve si: femra dhe krimi, të miturit dhe krimi si dhe janë përpjekur të shpjegojnë dallimin e madh që ekziston në përfshirjen e meshkujve dhe të femrave në krim, jo vetëm në vendet perëndimore por edhe në ato në zhvillim ose të Evropës Jug-Lindore²⁷.

Sa i përket gjinisë së viktimave të krimeve të vrasjeve , ato më tepër janë të gjinisë mashkullore . Mirëpo edhe femrat paraqiten si viktima të krimeve të vrasjeve. Ky konstatim deri diku përputhet edhe me faktin se edhe në kryerjen e krimeve të vrasjeve meshkujt marrin pjesë disa herë më shumë se femrat. Kërkimet e ndryshme viktimologjike dhe kriminologjike në vende të caktuara vërtetojnë se femrat janë disa herë më shumë viktimë e krimit të vrasjeve sesa që janë kryerëse të këtyre krimeve. Autori i mirënjohur slloven Janez Pecar në studimet e veta lidhur me viktimat e krimeve kundër jetës dhe trupit e veçmas vrasjeve në Slloveni ka konstatuar se femrat janë viktimë e atakimeve dhe sulmeve fizike në 49.6% të rasteve të vrasjeve , në 34.7% të rasteve të lëndimeve të lehta trupore , në 25.7% të rasteve të lëndimeve të rënda trupore. Studimet e krimeve të vrasjeve në territorin e Republikës së Maqedonisë në periudha të ndryshme kohore si nga viti 2005 e deri në vitin 2015 , përafërsisht tregojnë parametra të njëjtë të pjesëmarrjeve të femrave si viktima të këtyre krimeve si dhe parametra të viktimave të krimeve të vrasjeve të gjinisë mashkullore.²⁸

Tabela 3

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Gjinia mashkullore	42	42	30	28	23	28	29	18	15	23	20

²⁶ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 69 , 70.

²⁷ Po aty

²⁸ Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë , Shkup 29.12.2016
Byroja për Siguri Publike

Gjinia femërore	11	9	11	8	13	13	3	11	7	10	5
----------------------------	-----------	----------	-----------	----------	-----------	-----------	----------	-----------	----------	-----------	----------

Gjithsej viktimat e krimeve të vrasjeve sipas raportit të Policisë gjatë periudhës 2005-2015	Meshkuj : 298 viktimat të vrasjeve	Femra : 101 viktimat të vrasjeve
---	---	---

Në tabelën e mësipërme kemi pasqyruar ndarjet e viktimave të krimeve të vrasjeve në bazë të gjinisë, të gjinisë mashkullore, ku kjo gjini zë një numër më të madh me 298 të krimeve të vrasjeve dhe të gjinisë femërore që zë një numër prej 101 të krimeve të vrasjeve.²⁹

2.8. Mjetet dhe metodat e përdorura gjatë viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015

Mjetet e përdorura gjatë viktimizimit për kryerjen e veprës penale të vrasjeve janë të shumëllojshme, ndërsa si mjete më të shpeshta që hasen për kryerjen e veprës penale bëjnë pjesë armët e zjarrit, armët e ftohta, sende të forta, si dhe vegla të ndryshme, të cilat shkaktojnë lëndime vdekjeprurëse. Nga praktika penale juridike ne mund të konstatojmë se mjetet që janë përdorur më së shumti për kryerjen e veprës penale vrasje janë armët e zjarrit, mandej mjetet tjera si mjetet e mprehta dhe mjetet e forta³⁰. Në territorin e Republikës së Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015 numri i krimeve të vrasjeve shënon rënie dhe sillet në 381. Nëpërmjet një interviste telefonike të shkurtër të kryer më 07.02.2017 kam mundur të siguroj nga ana e organeve gjyqësore një statistikë për mjetet me të cilat janë kryer vrasjet që nga viti 2011, të cilën e paraqes në vijim.

Tabela 3

²⁹ Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë, Shkup 29.12.2016
Byroja për Siguri Publike
Kërkesa apo akti numër: 22.80239/1
Numri Arkivor i Policisë 22.4-5209/2.

³⁰ Ragip Halili: „Viktimologjia” 2011 Prishtinë, faqe: 70, 71.

Mjetet me të cilat janë kryer vrasjet	Tetovë	Shkup	Kumanovë	Strugë	Gostivar
Armë zjarri	58	/	89	/	/
Armë të ftohta dhe mjete të forta	8	/	16	/	/

Për arsye të ndryshme mundësi qasjeje kam pasur vetëm në Gjykatën Themelore të Tëtovës si dhe atë të Kumanovës, dhe atë prej vitit 2011-2015. Pra, vetëm për 6 vitet e fundit kam mundur të siguroj një statistikë të shkurtër në lidhje me mjetet që janë përdorur gjatë kryerjes së vrasjeve. Në tabelë shihet qartë se në Tetovë 58 vrasje janë kryer me armë zjarri, kurse vetëm 8 janë kryer me armë të ftohta dhe me mjete të forta. Në Kumanovë janë kryer 89 vrasje me armë zjarri, ndërsa me armë të tjera janë kryer 16 vrasje.³¹

2.9. Viktimat e hakmarrjes dhe gjakmarrjes si formë e veçantë në Republikën e Maqedonisë

Dhuna në formë të hakmarrjes dhe gjakmarrjes si gjykim personal, shkakton vrasje dhe plagosje të shumë njerëzve. Zakoni i hakmarrjes dhe gjakmarrjes edhe sot e kësaj dite në disa ambiente shkakton viktima në njerëz, çregullime dhe prishje të raporteve familjare , farefisnore , miqësore , shoqërore emocionale, raporteve ekonomike dhe raporteve të tjera mes qytetarëve në vendbanime të caktuara.³²Në praktikën gjyqësore si vrasje për hakmarrje të paskrupullt mund të konsiderohet kur hakmarrja është e drejtuar ndaj anëtarit të pafajshëm të familjes. Hakmarrja e paskrupullt ka disa elemente të përbashkëta me hakmarrjen dhe gjakmarrjen, por ka edhe disa dallime të rëndësishme të cilat i përkasin vetë personalitetit të kryerësit të vrasjes dhe hakmarrjes. Si vrasje për hakmarrje kemi vrasjen e ish zëvendës drejtorit për të ardhura publike me initiale A.A., që u konfirmua si vrasje për hakmarrje nga ana e kryefamiljarit B.K., e cila ndodhi më 25.07.2015 në qytetin e Strugës.³³ Gjakmarrja si fenomen çdoherë fillon me një mosmarrëveshje, zakonisht mes dy personave, që pastaj perfundon me tragjedi më të madhe,

³¹ Gjykata Themelore e Tetovës, Programi Akmis i Gjykatës Themelore të Tetovës 07.02.2017.

³² Ragip Halili: „Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 73 , 74.

³³ <http://indeks.mk/index.php?pagename=read&newsid=9617>

mandej ajo vazhdon me përfshirjen edhe të shumë personave të tjerë familjarë. Zënka që fillon e që përfundon në gjakmarrje mund të ketë çfarëdo lloj elementi apo shkaku si: fyerje, sharje, ofendime, mosmarrëveshje dhe shumë të tjera. Mosmarrëveshja është njëra ndër elementet që përshkallëzohet e që përfundon me përleshje fizike, po edhe me vrasje, pra njëri vret tjetrin që konsiderohet vrasja e një anëtarit të familjes, e cila e çon drejt në gjakmarrje. Kështu për t'u larë borxhi vjen deri te gjakmarrja, me ç'rast familja e të vrarit detyrohet t'i marrë jetën anëtarit të familjes së vrasësit dhe në këtë mënyrë fillon edhe konflikti ndërmjet familjeve që mund të vijë deri te shkatërrimi total i familjeve. Ky fenomen në vendin tonë është më i rrallë në krahasim me vendet tjera si Shqipëria e Kosova, prandaj duhet të intervenohet me pajtimin e familjeve që të mos vijë deri te vrasjet në varg.

2.1.2. Kompensimi dhe mbrojtja e anëtarëve të familjeve të viktimave të vrasjes

Aneksi i deklaratës së OKB-së mbi parimet themelore të drejtës për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, në nenin 2 mbi nocionin viktimë parasheh për anëtarët e familjes së viktimës këtë nocion: Fjala „ viktimë ” gjithashtu përfshin familjen dhe personat të cilët varen nga viktimat e drejtpërdrejtë dhe personat të cilët kanë pësuar lëndime për shkak se kanë ndërhyrë në mënyrë që t'u dalin në ndihmë viktimave në halle ose që ta parandalojnë viktimizimin e tyre. Nga kjo nënkuptojmë se edhe anëtarët e familjeve të viktimave në përgjithësi, por edhe në veçanti të viktimave të vrasjeve dëmtohen nga viktimizimi apo humbja e një personi të familjes së tyre. Dëmtimi është i dylojshëm : moral apo shpirtëror, sepse familja humb një nga anëtarët e vet, si dhe ekonomik apo financiar sepse ndoshta humb të ardhurat kryesore për mbajtjen materiale të saj. Në nenin e këtij aneksi thuhet: Kryerësit e veprave penale apo palët e treta që mbajnë përgjegjësinë për sjelljet e tyre sipas nevojës duhet t'u japin një dëmshpërblim të drejtë viktimave, familjarëve të tyre dhe personave të varur nga to, një dëmshpërblim i tillë duhet të përfshijë edhe kthimin e pronës dhe të pagesave për dëmtimet apo humbjet të cilat i kanë pasur ata, kompensimin e shpenzimeve të cilat janë bërë si rezultat i viktimizimit si dhe ofrimin e shërbimeve dhe rikthimin e së drejtës që u takon.

Neni 12 i këtij aneksi e sqaron më mirë kompensimin e familjeve të viktimave. Neni 12 i këtij aneksi thotë kështu : Kur kompensimi nuk jepet nga ana e kryerësit të veprës penale apo nga ndonjë burim tjetër, shteti duhet të përpiqet që të sigurojë kompensimin për :

- a- Viktimat që kanë pësuar lëndime të rënda trupore apo keqësim të gjendjes fizike apo mentale si rjedhojë e krimeve serioze;
- b- Familjet në veçanti personat e varur të viktimave që kanë vdekur si rezultat i një viktimizimi të tij.

Në këtë, nën respektivisht në pikën B, theksohet se duhet t'u ndihmohet atyre familjeve që pësojnë fatkeqësi nga vdekja e ndonjë anëtarit brenda familjes së tyre. Nga e gjithë kjo nënkuptojmë se së pari këto kompensime duhet t'i bartë personi që ka shkaktuar viktimizimin e rastit, mirëpo nëse personi apo vrasësi i viktimës nuk mund apo nëse nuk dihet se ku është, atëherë shteti duhet t'i marrë përsipër këto obligime.³⁴ Po ashtu edhe Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunës e miratuar në Strasburg flet për kompensimin e familjeve të cilat kanë pësuar nga humbja e anëtarit të tyre nga kriminaliteti i dhunës. Neni 2 thotë kështu:

- a- Ata të cilët kanë pësuar dëme fizike serioze apo dëmtime të shëndetit si rezultat i drejtpërdrejtë nga krimi i qëllimshëm i dhunës
- b- Personat e varur nga personat të cilët kanë vdekur si rezultat i krimeve të tilla.

Në përgjithësi mund të konstatojmë se ka kompensim për familjet e viktimës së vrarë.³⁵

2.1.3 Mjetet dhe motivet e vrasjeve

Metodat dhe mjetet që përdoren për ti shkaktuar vdekjen me dhunë personit në mënyrë të kundërligjshme janë të shumta , si metoda më të shpeshta në praktikë apo në jetën e përdishme përdoren si : mbytja me lak , me duar , në ujë , vrasja , shkaktimi i dëmtimeve trupore , djegja , helmimi etj. Ndërsa si mjete më të shpeshta përdoren arma e zjarrit , armet e ftohta , mjete te rastit , si shkop , gurë , sëpatë etj. Në shumicën e rasteve në praktikë apo në jetën e përdishme në vrasje përdoren më shumë armët e zjarrit , armët e ftohta dhe mjetet e rastit. Motivi është mobilizues-

³⁴ Aneksi i Deklaratës së OKB-së mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e keqpërdorimit të pushtetit (Viktimilogjia – Prof.Dr. Ragip Halili fq. Po aty.

³⁵ Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të dhunës , Strasburg 24.11.1983 (Viktimilogjia – Prof.Dr. Ragip Halili).

lëvizës i aktivitetit të njeriut , motivi është fuqi e brendshme psikologjike që nxitë dhe aktivizon njeriun në aksion të caktuar. Ky aksion mund të manifestohet në formë të veprimit dhe mosveprimit , të durimit ose në ndonjë formë tjetër. Mirëpo motivi nuk është vetëm nxitës dhe aktivizues por gjithashtu edhe drejtues i aksionit, duke ja përcaktuar drejtimin dhe intesitetin e veprimit si dhe modalitetin e manifestimit të tij. Kuptimi i këtillë i motivit është i pranishëm në psikologjinë bashkëkohore , ndonëse ki kuptim i përgjithashëm është shprehur me definicione tejet të ndryshme , Motivi është „ nxitja” e kuptuar me vetëdije i krijuar në bazë të nevojave. Edhe motivet që i shtyjnë fajtorët të kryejnë vrasje janë të dryshme si : për interes , për hakmarje si dhe për gjakmarje , zakoni i gjakmarjes i trashëguar nga lashtësia ka lindur për një shkak të një varg faktorësh objektivë e subjektivë , të brendshëm e të jashtëm edhe keta faktorë kanë vepruar që në Shqipëri të vazhdonte më gjatë por gjithsesi ai është rregulluar me hollësi në normat e kanuneve mesjetare , gjurmët e të cilave kanë arritur në kohën tonë. Vrasja për gjakmarje gjen rregullim juridik të plotë në kanunin e Lekë Dukagjinit , në kanunin e Skendërbeut në kanunin e Labërisë si dhe në kanune tjera lokale. Për të marrë hak për vdekjen e njerit prej të afërmeve , një familje mund të vriste cdo mashkull të familjes se vrasësit që kur ishte foshnje sipas rregullave të gjakmarjes të paraparë me të drejtën zakonore shqiptare përkatsisht sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit që i respektohen mjaft në veri të Shqipërisë. Në fund të vitit 1997 në rajonin e Shkodrës afro 2000 familje rreth 10 000 veta ishin në gjak , gjë që do të thotë se të gjithë meshkujt e këtyre familjeve nuk mund të dilnin nga shtëpia , se rezikoheshin të vriteshin për xhelozë , për të mbuluar një krim tjetër , për qëllime rugacërie për ti hequr qafë personat që e pengojnë fajtorin ta arrijnë qëllimin kriminal. E drejta zakonore e Labërisë ndaj personit që kryente një krim parashikonte masat si : gjakmarje, dëbim nga fshati , bojkotin , gjobë , dënim me vdekje prerja e gjymtyrës etj. Vrasjet nga pakujdesia paraqesin vështirsi ne hetim vetëm ne rastet kur fajtori mer masa për mbulimin e gjurmëve , kur përpiqet të paraqes vdekjen sikur ka ndodhur nga një sëmundje , nga një rast fatkeqsie ose sikur ka vetvrasje. Në këto raste hetimi zhvillohet sikur ndodhemi para një vrasje me dashje. Zbulimi i motivit ndihmon dukshëm në sqarimin e vrasjes në tërësi.³⁶

³⁶ Vesel Latifi „ Kriminalistika” Prishtinë- 2011 fq. 361-362.

KAPITULLI I TRETË

Mbrojtja dhe ndihma e viktimave të krimit

3.Mbrojtja dhe ndihma e viktimave gjatë viktimizimit primar

Në literaturën dhe teorinë viktimologjike, si viktimizim primar konsiderohet pësimi direkt që viktima apo mbijetuesi i rastit viktimizues e përjeton atë. Pasoja më të shpeshta që hasen gjatë përjetimit të viktimizimit mund të jenë : fizike , psikike dhe materiale. Në shumë vende të tjera të botës, po ashtu edhe në vendet tona si në Shqipëri , në Kosovë dhe në Maqedoni paraqitet si nevojë e kohës së studimit , hulumtimit dhe kërkimit shkencor për çështjet që kanë të bëjnë me viktimin e krimeve të vrasjeve, si dhe në veçanti me pozitën e saj në sistemin e drejtësisë penale. Në shumë vende të botës që janë më të zhvilluara sa i përket mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave, ka një orientim serioz dhe qasje praktike për trajtim adekuat dhe dinjitoz të personave që kanë pësuar nga krimet në çfarëdo forme, prandaj për këtë edhe janë nxjerrë shumë konventa , rregullore, rekomandime , ligje për të garantuar mbrojtjen nga aspekti juridik. Duke theksuar se iniciativat për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe realizimin e të drejtave të tyre janë të mirëseardhura nga të gjithë , mirëpo iniciativa e institucioneve ligjvënëse për nxjerrjen e normave juridike në këtë drejtim ka një rëndësi të posaçme , pra mbrojtja adekuate e viktimës së krimit në rend të parë nënkupton një përcaktim të saktë të të drejtave të njeriut me akte juridike.³⁷

3.2.Marrja në pyetje dhe mbrojtja nga viktimizimi sekondar

Marrja në pyetje dhe mbrojtja nga viktimizimi sekondar nënkupton një proces shumë të rëndësishëm mes nënpunësve të policisë dhe viktimës. Viktima duhet të ketë besim të madh ndaj institucioneve, siguri të madhe për denoncim të ndonjë ngjarjeje apo për biseda lidhur me procesin e ngjarjeve, për të evituar frikën dhe pasigurinë e viktimës në rastin e denoncimeve viktimizuese në praktikë dhe për të inkurajuar viktimat që t'i paraqesin ato. Ekzistojnë shumë këshilla , rekomandime të rëndësishme dhe të nevojshme si:

³⁷ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 139 , po aty.

- Viktimës në rast të parë duhet t'i ofrohet siguri maksimale për të treguar të vërtetën, që t'i shprehë të gjitha ndjenjat lidhur me të ;
- Viktimës duhet t'i sigurohet ambienti i marrjes në pyetje, zakonisht mënyra e marrjes në pyetje duhet të bëhet mes viktimës dhe nënpunësit apo zyrtarit të policisë që nënkupton në katër sy;
- T'i ofrohet mënyrë më e shpejtë apo nevojat më të domosdoshme për mjekim apo për sigurim fizik;
- Viktimës duhet t'i ofrohet kontakt me familjarët, me këshilltarë ose avokatë ;
- Polici apo zyrtari i policisë në bisedën e parë me viktimën duhet vepruar me shumë profesionalizëm që viktima të artikulojë gjithë ngjarjen në mënyrë të ligjshme dhe pa paragjykime për deklaratat e tij;
- Në mënyrë profesionale zyrtari i policisë nuk guxon që viktima të ndihet fajtor apo të tregojë mosbesim ndaj institucionit, pra zyrtari duhet t'i garantojë viktimës siguri të plotë dhe fshehtësi të garantuar që në të ardhmen do të mund të ndikojë në jetën intime të viktimës;
- Me marrjen në pyetje, zyrtari i policisë duhet t'i parashtrojë pyetje të qarta , të kuptueshme;
- Të informojë viktimën për të drejtat e tij që i gëzon;
- Të mos jetë arogant gjatë marrjes në pyetje, por në menyrë profesionale të zbulojë shumëçka.³⁸

Nga e gjithë kjo nënkuptojmë se organet e rendit apo institucionet e policisë, të cilët janë legjitimë për marrjen në pyetje të viktimave, duhet të veprojnë në menyrë shumë profesionale , pa arogancë. Në bisedën mes viktimës dhe zyrtarit të policisë në katër sy viktimës duhet t'i sigurohet gjithçka që ajo të mund të tregojë apo t'i shprehë të gjitha fshehtësitë, ndërsa fshehtësia e viktimës duhet të jetë e garantuar e jo të keqpërdoret nga ana e institucionit apo zyrtarit të policisë , që në të ardhmen të ndikojë negativisht në jetën private të saj.

³⁸ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: po aty.

3.3. Informimi dhe njohja e viktimës me të drejtat e saja në procedurë

Me informimin dhe njohjen e viktimës me të drejtat e saja në procedurë nënkuptohet që viktima të njihet me të drejtat në procedurat e hetimit, akuzës, si edhe me pjesëmarrjen e saj në seancën kryesore , ku trajtohet çështja lidhur me viktimizimin e saj. Ajo ka të drejtë që vetë të konsultojë , t'i lexojë, si dhe të njihet me shkresa dhe prova që janë relevante për realizimin e kërkesave të parashtruara. Gjatë paraqitjes në gjykatë apo para ndonjë organi tjetër lidhur me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të saj apo realizimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga kryerësi i veprës penale, pa marrë parasysh qoftë viktima si palë e dëmtuar apo si palë dëshmitare, sipas Deklaratës së OKB-së dhe rekomandimeve të konventave të ndryshme, por edhe sipas ligjeve nacionale viktima gëzon një varg të drejtash.³⁹

3.4. E drejta në respektimin e dinjitetit dhe integritetit moral dhe personal

Në të gjitha rastet e marrjes në pyetje, dhenies së deklaratës, si dhe intervistave , zyrtarët e policisë që i zbatojnë ato duhet të kenë parasysh respektimin e dinjitetit dhe integritetit fizik , moral dhe familjar të viktimës, në asnjë rast viktimës nuk duhet t'u shtrohen pyetje provokuese , fyese apo diskriminuese në baza fetare , nacionale , raciale, si dhe sipas përcaktimit seksual etj. Kur është në interes të mbrojtjes së viktimës duhet të sigurohen kushte që viktima të dëshmojë në lokal apo në sallë gjykimi pa praninë e publikut , po ashtu kur konsiderohet se ballafaqimi me kryerësin apo viktimizuesin do të ndikojë që ajo të reviktimizohet apo të pësojë strese , trauma e shqetësime të rënda , asaj duhet t'i mundësohet të deponojë deklarata me videoinçizime dhe në distanca , pa kontakt të drejtpërdrejtë me viktimizuesin e vet. Viktimës duhet t'i krijohen dhe t'i garantohen kushte dhe atmosferë e sigurt të ardhjes në gjykatë gjatë kohës së zhvillimit të procedurës gjyqësore. Në këtë shkallë duhet të eliminohen të gjitha kërcënimet apo mënyrat e tjera të ushtrimeve të presionit ndaj viktimës apo anëtarëve të familjes së saj. Viktima ka të drejtë si palë e dëmtuar të parashtojë kërkesat gjatë procedurës, si dhe të ofrojë prova , të bëjë

³⁹ Ragip Halili: „ Viktimologjia” 2011 Prishtinë , faqe: 142.

plotësime të deponimeve të mëparshme. të shtrojë pyetje dhe të kërkojë sqarime. Të gjitha këto veprime mund t'i ndërmarrë vetë ose nëpërmjet avokatit apo përfaqësuesit të vet.

3.5.E drejta e viktimës në mbrojtje profesionale

Në praktikë shpesh ndodh që mbrojtja e kryerësit apo edhe ai vetë gjatë procedurës së marrjes në pyetje apo gjatë procedurës së provave dhe ballafaqimeve të sulmojë viktimën, të bëjë përpjekje që ta diskreditojë duke bërë aluzione të ndryshme për moralin, si dhe për vetitë e tjera negative të saj me qëllim që të nxirren pika lehtësuese për kryerësin e veprës penale. E drejta e viktimës në mbrojtje profesionale është që asaj duhet t'i sigurohet konfidentialitet i plotë në të gjitha fazat e procedurës, po ashtu duhet t'i garantohet ruajtja e intimitetit, si dhe mospublikimi i rrethanave komprometuese. Viktima si palë e dëmtuar apo si palë që ka parashtruar kërkesë për zhdëmtim apo kompensim. Nëse ajo është e pakënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka të drejtë të bëjë ankesë deri ke gjykata e shkallës më të lartë.

Meqenëse kërkesa e viktimës për dëmshpërblim dhe kompensim rëndom nuk zgjidhet në procedurë penale, ku edhe procedohet përgjegjësia e kryerësit të veprës penale, ka ide dhe propozime që kjo çështje të mos udhëzohet në gjykimin civil por edhe kjo kërkesë të gjykohet së bashku me çështjen kryesore. Në këtë mënyrë do të shmangej praktika e kontesteve dhe gjykimeve të gjata, që e lodhin dhe e dekurajojnë viktimën të qëndrojë deri në fund. Në shumë ligje mbi mbrojtjen e viktimave dhe mbi kompensimin e dëmit , përveç tjerash është paraparë që pagesat për dëmshpërblim dhe zhdëmtim ndaj viktimës kanë përparësi në krahasim në shpenzimet e gjykatës. taksat apo pagesat tjera. Prandaj viktima duhet të mbrohet në mënyrë më profesionale në gjykimin e drejtë si dhe në asnjë formë diskriminuese.⁴⁰

3.6.E drejta e viktimës në lëvizje të lirë

Me të drejtë lëvizje të lirë të viktimave nënkuptojmë që viktimës duhet t'i mbrohet gjithçka si nga dhuna në përgjithësi, nga kërcënimet që viktima të mos përballohet me këto lloje kërcënimesh, që ajo në të ardhmen të mund të lëvizë e lirë, lëvizja e lirë e viktimës të mbrohet

⁴⁰ Prof.Dr. Ragip Halili : „, Viktimilogjia” 2011 Prishtinë , faqe: 143,144.

me ligj siç parashihet në kodin penal mbi mbrojtjen e viktimave për lëvizje të lirë. Që viktimat të ketë të drejtën e lëvizjes së lirë kryerësve dhe viktimizuesve u ndalohej :

- kontakti fizik,
- kontakti me telefon,
- Qasje në hapësirë , lokale , vendbanime , shtëpi , vende të punës, si dhe territor në distanca me parametra të caktuar. Kjo ka të bëjë më së shumti kur viktimat janë gra të keqtrajtuara apo partnerë heteroseksualë, si dhe homoseksualë apo fëmijë të abuzuar si dhe persona të tjerë të cilët ndihen të rrezikuar nga kërcënimet, ngacmimet dhe bezdisjet e pandërprera të viktimizuesve.⁴¹

3.7 Të drejtat e viktimës

Viktima e veprës penale gëzon disa të drejta në procedurë penale. Disa prej të drejtave *u përkasin përgjithësisht viktimave të veprës penale*, disa të drejta janë të veçanta *për kategori të cënuara të viktimave* dhe disa të tjera kanë të bëjnë *me viktimat e veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare*.

Sipas nenit 53 të LPP-së viktimat e veprës penale i ka të drejtat që do t'i theksojmë në vijim:

- 1) Të marrë pjesë në procedurë penale si i dëmtuar duke u kyçur në ndjekje penale ose për realizimin e kërkesës pasurore juridike;
- 2) Në kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e pjesëmarrësve në procedurën penale dhe
- 3) Në ndihmë efektive psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave të veprave penale.

Organet e procedurale (policia, prokurori publik dhe gjykata) veprojnë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke u dhënë këshilla për të drejtat e tyre dhe duke u kujdesur për interesat e tyre. Në çështjet penale ku është paraparë dënim me burgim prej së paku katër vitesh viktimat ka të drejtë për:

⁴¹ Ragip Halili: , Viktimologjia ‘‘ 2011 Prishtinë , faqe: po aty.

a) *Këshilltar* në llogari të mjeteve buxhetore para dhënies së dëshmisë, përkatësisht deklaratës ose parashtrimit të kërkesës për të drejtën pasurore juridike, nëse ka lëndime të rënda psikofizike ose pasoja më të rënda nga vepra penale dhe

b)) *Kompensim* të dëmit material dhe jomaterial nga fondi shtetëror në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari.

Disa kategori viktimash (si kategoria “viktimë e rrezikuar” dhe “viktimë veçanërisht e ndjeshme”), përveç të drejtave të sipërpërmendura (të drejtat sipas nenit 53), kanë të drejtë për masa të veçanta të mbrojtjes procesore gjatë dhënies së deklaratës dhe marrjes në pyetje në të gjitha fazat e procedurës. Kështu, viktimë e rrezikuar konsiderohet viktimë e cila në kohën e dhënies së dëshmisë është në moshë nën 18 vjet dhe viktimë e cila me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta ekspozojë vetveten ose personin e afërt në rrezik për jetën, shëndetin ose integritetin fizik. Viktimë veçanërisht e ndjeshme konsiderohet viktimë e cila për shkak të moshës, natyrës dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik ose psikik ose gjendjes tjetër shëndetësore me rëndësi, të kaluarës shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve fetare dhe përkatësisë etnike të viktimës, sjellja e të pandehurit, e anëtarëve të familjes ose miqve të të pandehurit ndaj viktimës, do të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin e tyre psikik ose fizik ose negativisht do të ndikojë mbi cilësinë e dëshmisë së dhënë. Masat e posaçme të mbrojtjes procesore i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës ose me vlerësimin e vet, gjithnjë duke e marrë parasysh vullnetin e viktimës. Mirëpo, gjykata domosdo duhet të caktojë masë mbrojtje procesore për fëmijën viktimë, i cili ka moshë nën 18 vjet, apo kur fëmija është viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual. Me rastin e caktimit të masës mbrojtëse procedurale ndaj fëmijës viktimë, gjykata doemos duhet të përcaktojë video ose audio inçizim për deklarimin dhe marrjen në pyetje të fëmijës në mënyrë që inçizimi të përdoret si provë në procedurë. Vetëm në raste ekskluzive, për shkak të rrethanave të reja të rastit, gjykata mund të urdhërojë që të përsëritet marrja në pyetje e fëmijës viktimë, më së shumti edhe një herë nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve teknike për komunikim (neni 54). Zbatimi i masave të posaçme për mbrojtjen procesore të fëmijëve viktimë është rregulluar me ligj të posaçëm. Viktimë e veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, përpos të drejtave nga neni 53 i LPP-së, ka edhe të drejta të tjera për të cilat

organi procedural duhet ta këshillojë më së voni para marrjes në pyetje për herë të parë për çfarë hartohet shënim zyrtar ose procesverbal. Të drejta të tilla janë ato që:

- 1) Para marrjes në pyetje të bisedojë me këshilltar pa pagesë ose me person të autorizuar, nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar;
- 2) Të merret në pyetje nga personi i të njëjtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike;
- 3) Të mos përgjigjet në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës, e nuk janë të lidhura me veprën penale;
- 4) Të kërkojë marrjen në pyetje me ndihmën e mjeteve vizuele - të zërit në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe
- 5) Të kërkojë përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor.

Për të pasur mundësi t'i realizojë të drejtat e veta ligjore, viktimja do të duhej të njoftohet nga organi procedural për zhvillimin e procedurës penale. Mirëpo, viktimja e cila nuk është e njoftuar për të drejtën e saj që të marrë pjesë në procedurën si e dëmtuar (p.sh. nuk është njoftuar meqë organi procedural nuk ka njohuri për atë se kush është viktimë e veprës penale), ka të drejtë të paraqitet në polici ose prokurori publike si e dëmtuar deri në parashtrimin e aktakuzës, ndërsa para gjykatës deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.⁴²

3.8. Të drejtat e tjera të të dëmtuarit

I dëmtuari mund të angazhohet për realizimin e suksesshëm të ndjekjes penale të ushtruar nga prokurori publik. Në këtë drejtim sipas nenit 57 të LPP-së i dëmtuari në procedurë penale ka të drejtat si në vijim:

- 1) Të njoftohet me të drejtat e tij;
- 2) Ta përdorë gjuhën e tij dhe alfabetin dhe të drejtën e ndihmës së përkthyesit, përkatësisht interpretuesit nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura;

⁴² Ejup.S&Ismail.Z, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup,2017.fq.108.

- 3) Të propozojë realizimin e kërkesës pasurore juridike;
- 4) Të ketë person të autorizuar;
- 5) Të tregojë fakte dhe të propozojë prova;
- 6) Të marrë pjesë në seancën dëshmuese;
- 7) Të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor dhe në seancën dëshmuese, si dhe të deklarohet për kërkesën juridiko pronësore edhe për ngjarjen juridiko penale;
- 8) Pas përfundimit të procedurës hetimore t'i shqyrtojë shkresat dhe sendet që shërbejnë si prova. Mirëpo, sipas nenit 64, paragrafi 3 të dëmtuarit mund t'i shkuttohet e drejta e shqyrtimit të dokumenteve, derisa nuk merret në pyetje si dëshmitar;
- 9) Të parashtrojë ankesë me kushtet e parapara me LPP;
- 10) Të parashtrojë propozim për ndjekje dhe padi private në pajtim me dispozitat e Kodit penal;
- 11) Të njoftohet për mosmarrjen ose për çdo heqje dorë nga ndjekja penale nga ana e prokurorit publik;
- 12) Të parashtrojë ankesë prokurorit publik më të lartë kundër vendimit të prokurorit publik me të cilin ai është hequr nga ndjekja penale, nën kushtet e parapara me LPP;
- 13) Të kërkojë kthimin në gjendjen e mëparshme;
- 14) T'i respektohet e drejta e privatësisë dhe
- 15) Të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me LPP.

I dëmtuari paraqitet si subjekt sekondar të veprat penale të cilat prokurori publik i ndjek sipas detyrës zyrtare. Mirëpo, duhet potencuar faktin se në disa raste, ndonëse është paraparë ndjekja ex officio, ndjekja e tyre është kushtëzuar me paraqitjen e propozimit

për ndjekje nga i dëmtuari. Ndërsa te veprat penale, të cilat ndiqen me padi private, personaliteti i të dëmtuarit identifikohet me personalitetin e paditësit privat.⁴³

3.9 Të drejtat e viktimave dhe mbrojtja e tyre sipas parimeve bazë dhe aneksit të Deklaratës së OKB-së të vitit 1985

Duke kujtuar se kongresi i Gjashtë Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Delikuentëve i ka rekomanduar KB-së që të vazhdojnë veprimtarinë e vet në zhvillimin e udhëzimeve dhe synimeve në drejtim të pengimit të keqpërdorimit të pushtetit politik dhe ekonomik ,

- Duke ditur se me miliona njerez në tërë botën pësojnë dhe vuajnë nga krimi dhe keqpërdorimi i pushtetit dhe se të drejtat e tyre nuk janë të mbrojtura në masë të duhur ,
- Duke marrë parasysh se viktimat e krimit dhe të keqpërdorimit të pushtetit e shpesh herë edhe familjet e tyre , dëshmitarë dhe të tjerët që ndihmojnë i nënshtrohen rrezikut të lëndimeve e dëmeve ose pësojnë duke marrë pjesë në procedurën kundër kryesit ,
 1. Konstaton domësdoshmërinë e ndërmarjes së masave , si në nivelin e vendeve të ndryshme , apo ashtu edhe në nivelin e bashkësisë ndërkombëtare të cilat kanë për qëllim mbrojtjen efikase të të drejtave të viktimave të krimit dhe viktimave të keqpërdorimit të pushtetit ,
 2. Thekson se është e domosdoshme që në të gjitha shtetet të inicohet dhe të avancohet mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave duke mos i cenuar të drejtat që u përkasin të dyshuarve dhe të dënuarve,
 3. Miraton deklaratën mbi të drejtat themelore të viktimave të krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit të bashkangjirut rezolutës egzistuese e cila duhet tu ndihmojë vendeve të ndryshme dhe bashkësisë ndërkombëtare në përpjekjet e tyre që tu garantojnë të drejtën dhe ndihmën viktimave të krimit dhe të keqpërdorimit të pushtetit,

⁴³ Ejup.S&Ismail.Z, E drejta e procedures penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup,2017.fq.108.

4. Fton shtetet antare që të ndërmarin masa të domosdoshme në mënyrë që ti realizojnë parimet e Deklaratës , me qëllim që të zvoglohen pësimet apo vuajtjet e viktimave dhe këtë:
- a. Të instalojnë një politikë të nevojshme sociale , ekonomike , arsimore , shëndetësore si dhe një politikë adekuate të parandalimit të kriminalitetit në menyrë që të zvoglohet viktimizimi dhe tu sigurohet ndihma e viktimave në nevojë,
 - b. Të iniciojë një aksion të gjërë shoqërorë në parandalimin e kriminalitetit,
 - c. Të rishqyrtoj legjilacionin dhe praktikën e tyre në mënyrë që të bëhen ndryshime adekuate në drejtim të aplikimit dhe forcimit të përgjegjësisë juridike lidhur me cenimin e normave të pranura ndërkombëtarisht , që kanë të bëjnë me normat mbi të drejtat e njeriut , menyra e veprimit të personave juridik dhe të keqpërdorimit të pushtetit,
 - d. Të aplikojnë sistemin adekuat të zbulimit , ndjekjes dhe ndëshkimit të kryersve të krimit,
 - e. Që opinionit ti ofrojnë të dhëna relevante lidhur me kontrollin e punës dhe veprimit të shërbimeve publike dhe personave juridik,
 - f. Të angazhohen që puna dhe veprimtaria e shërbimeve publike , e organeve dhe judikaturës , shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe puna e shërbimeve e ushtrisë dhe institucioneve ekonomike të jetë e bazuar në parime etike morale e vecmas atyre që janë të pranura nga bashkësia ndërkombëtare,
 - g. Të pengohen keqpërdorimet lidhur me privim kundërligjor të lirisë,
 - h. Të bashkpunojnë më shtetet tjera nëpërmjet ndihmës juridike ndërkombëtare në leminë gjyqësore , administrative , sociale gjatë zbulimit , ndjekjes dhe ekstradimit të kryersve të krimit si dhe në sigurimin e reprecioneve të dëmit të shkaktuar nga pasuria e kryersit.⁴⁴

⁴⁴ Ragip Halili: , Viktimilogjia ‘ ‘ 2011 Prishtinë , faqe: 132-133.

KAPITULLI I KATËRT

4. Vështrimi mbi rastet veç e veç të viktimave të vrasjeve në territorin e Maqedonisë

Mbrojtja e jetës së njeriut ka karakter absolut, në kuptimin që jeta mbrohet pa marrë parasysh ndjenjën për jetë, interesin jetësor të individit, pa marrë parasysh vlerësimin e jetës së individit nga ana e shoqërisë, dhe pa marrë parasysh atë se për cilën fazë të jetës bëhet fjalë. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa përjashtime nga kërkesa për respektin absolut të jetës së njeriut, siç janë: lufta, dënimi me vdekje në disa legjislacione, vrasja në mbrojtje ekstreme, andaj, del se respekti ndaj jetës biologjike të njeriut ka të bëjë me orientimet themelore sociologjike dhe antropologjike të shoqërisë, me çka mund të konstatohet se e drejta themelore e njeriut në jetë duron edhe disa kufizime të caktuara sociale.⁴⁵

“Krimet ndaj jetës dhe trupit në shkencën juridiko-penale dhe atë kriminologjike, cilësohen si një ndër format më të rënda të atakimit të vlerave dhe të mirave më të shtrenjta të njeriut, megjithëse ato në masën e përgjithshme të krimeve të kryera, nuk janë edhe aq masive. Mirëpo, fakti se me veprimet e tilla kriminale atakohet jeta dhe trupi, rrezikohet shëndeti dhe siguria fizike e njeriut, ato, shpesh zënë vend qendror në trajtimet e ndryshme kërkimore-hulumtuese por, edhe në tekstet e caktuara universitare”⁴⁶.

4.1. Viktimat e krimeve të vrasjeve në qytetin e Tetovës

Një ngjarje që është shënuar në ditën e 13 tetorit të vitit 2013 në rrugën lokale Zherovjan – Pirok të komunës së Bogovinës pas të shtënave me armë zjarri ka mbetur i varur viktimë me inicialet M.A i moshës 32 vjeçare nga Tetova. Trupi i pajetë është gjetur nga patrulla policore mbrëmë rreth orës 21 e 40 minuta pranë automobilit “Golf 3” me targa të Tetovës në rrugën lokale drejt

⁴⁵ Dr.I.Zejneli. E drejta penale, pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, faqe.22

⁴⁶ Dr.I.Zejneli. Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2008, faqe.72, vepër e cituar

fshatit Pirok, informoi sot zëdhënësi i SPB-së së Tetovës, Marjan Josifovski. Policët derisa kanë qenë në patrullë të rregullt, e kanë vërejtur trupin e pajetë, i tëri i mbuluar në gjak pranë automobilit “Golf 3” që ka qenë në lëvizje dhe i lënë në vend. Trupi ka qenë në pozitë të shtrirë në shpinë dhe mbi pjesën e tij të epërme dhe në kokë ka pasur disa plagë hyrëse-dalëse. Menjëherë është thirrur ndihma e shpejtë, por mjekët vetëm kanë mundur të konstatojnë vdekjen e personit. Trupi i pajetë më vonë është konfirmuar se është M.A. Sipas urdhërit të gjykatësit hetues, i cili së bashku me ekipin e SPB-së të Tetovës dhe prokurorit publik kanë kryer ekspertizë në vendngjarje, trupi i pajetë është dhënë për autopsi, ndërsa gjatë kontrollit janë gjetur dy gëzhoja të zbrazëta të pushkës automatike të kalibrit 7,62 milimetra të cilat janë marrë së bashku me gjurmët e gjakut dhe gjurmë të tjera për analiza dhe për zbardhjen e plotë të rastit. Figura numër 1 si dhe figura numër 2 tregojnë pamjen e përgjithshme se ku ka ndodhur vrasja, respektivisht vendngjarjen.

Figura 1. Vendi i ngjarjes, në të cilin shihen gjurmë gjaku në rrugën lokale Zherovjan-Pirok të komunës së Bogovinës.



Figura numër 2. Vendi i ngjarjes si dhe gjurmë gjaku.⁴⁷

⁴⁷ ://www.albeu.com



4.2. Viktimat e krimeve të vrasjeve në Shkup

Veprën themelore të vrasjes ligji e definon duke e përdorur një formulim të përgjithshëm, privim të tjetrit nga jeta.⁴⁸

Objekti i mbrojtjes të të gjitha veprat e vrasjes është jeta e njeriut.

Vrasje e katërfishtë në Gllumovë të Shkupit

Vrasje e trefishtë dhe vetëvrasje në Shkup. Sh.S nga fshati Gllumovë sot ka vlarë vëllain dhe dy nipërit e tij, pas çka ka vlarë edhe veten. Ekipet e MPB-së dhe ekspertizës kanë kryer hetime në vendngjarje. Nga MPB-ja konfirmuan se të gjitha viktimat janë në lidhje familjare. Nga Prokuroria Themelore e Shkupit thonë se Prokuroria Publike lëshoi urdhër për grumbullimin e të gjitha provave materiale që janë gjetur në vendin e ngjarjes, që më vonë të dërgohen në ekspertizë. Trupat e viktimave do të dërgohen për obduksion, njoftojnë nga Prokuroria Publike. Nga Ministria e Brendshme thonë se për shkak të mospajtimeve familjare, Shabani i ka vlarë të afërmit e tij. Sipas informatave të para nga hetimi, shkak për ngjarjen tragjike me siguri janë zënkat familjare. Vrasësi, tre viktimat dhe i plagosuri janë anëtarë të një familjeje – tha Ivica Ilievski, zëdhënës i MPB-së. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 10 kur Sh.S nga fshati Gllumovë ka shkuar mysafir te djemtë e tij në lagjen Gjorçe Petrov 2. Sipas okularëve, personi me initiale Sh.S. ka shkuar në lagjen Gjorçe Petrov në rrugën “Panajot Ginovski” ku kanë jetuar djemtë e tij. Atje i ka takuar djemtë e vëllait, Muminin, Arijanin dhe Bariun që kanë qenë te djemtë e tij,

⁴⁸ Dr.V.Kambovski, E drejta penale pjesa e posaçme, Shkup, 1997, faqe,31

Nebiu dhe Zylqifliu. Ai ka shtënë drejt tyre. Nipërit Mumini dhe Arijani janë vrarë në vend, ndërsa Bariu është plagosur në bark dhe është dërguar në Qendrën urgjente në Shkup. Pasi e ka kryer aktin makabër, Sh.S. është nisur drejt fshatit Gllumovë. Në rrugë e ka takuar vëllain e tij Avdylin, pas çka ka shtënë edhe ndaj tij, të cilin e ka vrarë në vend. Familjarët e afërt të Sh.S. janë përpjekur ta qetësojnë dhe ta bindin t'i dorëzohet policisë, por ai pasi e ka parë policinë në oborrin e shtëpisë, është vetëvlarë me pistoletën e njëjtë me të cilën vrau anëtarët tjerë të familjes.

Verica Pavloska:

Këtë mëngjes është raportuar për një incident në Gllumovë të Shkupit, ku janë vrarë katër persona. Ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 10.00, ku vrasësi për arsye akoma të panjohura ka vrarë vëllain, dy nipërit dhe më pas edhe veten. “Sot rreth orës 10.00 nga ana e një personi është kryer vrasje e tre personave, njëri është vrarë në fshatin Gllumovë dhe dy në Kondovë. Njësitë Alfa ka kërkuar vrasësin në fshatin Gllumovë, por i dyshuari ka kryer vetëvrasje. Vdekja u konstatua nga ndihma e shpejtë dhe vrasësi dyshohet të jetë Sh.S. nga Gllumova. Tani pritet të kryhet hetimi për motivin e vrasjes si dhe të konfirmohet vrasësi”, tha Zëdhënësi i MPB-së, Toni Angelovski. Dëshmitarët okularë rrëfejnë se dorasi Shaban Sulejmani fillimisht ka shkuar në banesën e djemve të vet në lagjen “Gjorçe Petrov”. Atje i takon djemtë e vëllait, Muminin, Arijanin, Bariun dhe fëmijët e vet, Nebiun dhe Zulqeflin. Djemtë e vet ikin. Bariun e plagos në bark me dy plumba, ndërsa Mumini dhe Arijani kanë vdekur në vend. Prej aty dorasi merr rrugën për në Gllumovë rrugës e takon vëllain e vet, Avdylin. Vrasësi e shtyn viktimën në drejtim të veturës. I ndjeri ka tentuar të ikë, mirëpo dorasi qëllon me dy plumba afër zemrës dhe ai nuk arrin të mbijetojë. Edhe pse të afërmit u munduan ta bindin dorasin të dorëzohet, ai kur i sheh policët në oborrin e shtëpisë vret edhe veten. Në figurën e mëposhtme sjellim vendin se ku ka ndodhur vrasja apo fillmi i vrasjes në Gllumovë të Shkupit:

Figura numër 1. Pamja e përgjithshme e vendit të ngjarjes si dhe viktimat e shtrirë në tokë.



Viktimat e krimeve të vrasjeve në territorin e Gostivarit

Jeta e njeriut është e drejtë absolute, e drejtë natyrore dhe e drejta për jetë është para të gjitha të drejtave tjera. Me humbjen e jetës humbin të gjitha të drejtat tjera, humb ekzistenca e njeriut. Krahas jetës edhe integriteti trupor konsiderohet një ndër vlerat themelore të njeriut. Andaj është e kuptueshme se pse e drejta penale i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes së këtyre të mirave juridike.⁴⁹ E drejta penale e mbrojt jetën e njeriut që nga fillimi i saj deri në fund, deri vdekje.

Pacënueshmeria e jetës dhe integriteti trupor të ne është ngritur në rang të parimit kushtetues, (neni 10 i Kushtetutës së RM-së).

Respekti ndaj jetës së njeriut dhe integritetit trupor paraqet bazën elementare të civilizimit tonë. Historia e njerëzimit është edhe histori e luftës së njeriut për ekzistencën (mbijetesën) e tij fizike kundër vetëvetes (për dallim nga bota shtazore, në të cilën armik i njeriut lloj është lloji tjetër, ndërkas, armiku më i madh i njeriut, është, siç thuhet, vetë njeriu!). Sot nuk ekziston legjislacion penal që nuk u ofron mbrojtje këtyre të mirave themelore dhe më të vlefshme të njeriut. Vetëdija për karakterin e tyre universal është inkorporuar edhe në më shumë dokumente ndërkombëtare të rëndësisë fundamentale për liritë dhe të drejtat e njeriut (kështu: *Deklarata Universale për të drejtat e njeriut e OKB-së* e vitit 1948, neni 3; *Pakti për të drejtat*

⁴⁹ Dr.I.Saliu, E drejta penale, pjesa e posaçme, Prishtinë, 2006, faqe.111

civile dhe politike, neni 6, ku thuhet: çdo njeri ka të drejtën e lindur në jetë, që duhet të mbrohet me ligj; askush nuk mund në mënyrë arbitrare të privohet nga jeta).⁵⁰

4.3. Vrasje në Gostivar, arrestohet autori

Një person i vdekur në vendngjarje dhe një tjetër i plagosur, është bilanci i rastit tragjik të ndodhur të martën rreth orës 23:30 përballë Stacionit Hekurudhor në Gostivar. Siç njofton policia, viktimë është 62 vjeçari I.Z., kurse e plagosura me plumb në kokë është 39 vjeçarja Q.R. nga Dibra. Ndërhyrja e shpejtë e policisë, ka bërë të mundur kapjen e autorit në vendin e ngjarjes. Sipas njoftimeve të policisë, bëhet fjalë për 51 vjeçarin M.I. nga fshati Çegran i Gostivarit. Ai është prangosur nga organet e rendit disa minuta pasi ndodhi ngjarja e përgjakshme, pas çka është përcjellë në Stacionin Policor të Gostivarit, njofton Koha. I ndjeri I.Z. ka ndërruar jetë në vendngjarje nga plumbi i marrë në kokë, kurse e plagosura Q. R. pas dhënies së ndihmës së shpejt në Spitalin e Gostivarit, për shkak të lëndimeve serioze është bartur në Klinikën e Shkupit. Informatat e para flasin se gruaja e plagosur vazhdon të përballët me rrezikun për jetë. Nga Policia e Gostivarit njoftojnë se gruaja kishte marrë një plumb në kokë, kurse viktimë ishte qëlluar në kokë dhe gjoks. Gjithmonë, sipas policisë, ngjarja ka rrjedhur si rezultat i një grindjeje mes vrasësit dhe gruas së plagosur. Sipas informatave jo zyrtare, mësohet se viktimë me gruan kishte pasur lidhje dashurie. Gjatë ekspertizës, policia në vendin e ngjarjes ka gjetur tre gëzhoja, një plumb dhe një armë të kalibrit 6.35 milimetra me të cilën është kryer i vrasjes. Gjersa intervenimi i policisë ka qenë në kohë, me çka dëshmohet edhe me arrestimin e autorit të krimit, me orë të tëra kanë munguar në vendngjarje ekipet e prokurorisë publike dhe gjykatës hetuese. Kjo ka bërë që trupi i viktimës të mbetet i shtrirë në tokë për më shumë se një orë, dhe i pambuluar. Nga policia e Gostivarit njoftojnë se janë duke punuar për zbardhjen e plotë të rastit.⁵¹

⁵⁰ Dr.I.Zejneli. E drejta penale, pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, faqe.22

⁵¹ <http://www.albeu.com/maqedoni/vrasje-ne-gostivar-arrestohet-autori/88540/>

Përfundimi

Viktimat e krimeve të vrasjeve janë produkte të vrasjeve që është krimi më i rrëndë i një shoqërie. Xhdo shoqëri bashkëkohore në legjislacionin e tyre kombëtarë ka paraparë se vrasjet të cilat shkaktojnë viktima janë vepra penale dhe se dënimet janë paraparë për to në kodin penal. Viktimat e krimeve të vrasjeve janë lloj i vengant i viktimave të kriminalitetit të dhunës. Me viktimat e krimeve të vrasjeve në përgjithsi kemi ardhur në përfundim se nënkuptojmë marjen e jetës së njeriut në mënyrë të dhunshme më metoda si dhe mjete të ndryshme duke i përdorur për marjen e jetës së njeriut. Viktimat e krimeve të vrasjeve gjejnë studim në disa shkeca juridiko-penale sic janë : Kriminalistika , Mjekësia Ligjore , Kriminologjia dhe Viktimilogjia po ashtu ka edhe punime shkencore që meren më këtë problematike por edhe ky punim shkencor meret më këtë studim apo me këtë problematik ku për qëllim kryesor ka hulumtimin e viktime të krimeve të vrasjeve në Republikën e Maqedonisë. Marja e jetës është vepër penale dhe se është e dënueshme me cdo legjislacion ndërkombëtar. Maqedonia këtë e ka të rregulluar në Kreun e XIV të kodit penal të Maqedonisë , në nenin 123 të kodit penal të Maqedonisë ku parashihen të gjitha llojet e vrasjeve që nënkupton edhe viktimat që rjedhin nga kto vrasje. Sipas statistikave të vrasjeve të kryera që posedojnë organet e policisë në Republikën e Maqedonisë përgjat periudhës 2005 e deri në vitin 2015 kemi një numër 381 vrasje të kryera duke marrë krahasimin nga viti në vit gjegjësisht nga viti 2005 kemi patur më shumë vrasje ku ze një numër me 53 vrasje të kryera kurse në vitin 2013 kemi patur më pak vrasje që ze një numër 20 vrasje të kryera duke përfshirë prej vitit 2005 e deri në vitin 2015 në tabelën numër 1 do të shifet se kemi rënie të vrasjeve në teritorin e Maqedonisë. Duke u bazuar në tabelën numër 2 kemi nxjerë të dhënat statistikore të marë nga policia e Maqedonisë ku kemi bërë ndarjen edhe atë në secilin vit vec e vec duke i marë nga viti 2005 e deri në vitin 2015 të dhënat statistikore të policisë për viktimat e krimeve të vrasjeve në Maqedoni që ze një numër me 409 viktima të krimeve të vrasjeve po ashtu duke u bazuar në tabelën numër 2 shihet se nga viti me më shumë viktima të vrasjeve ka qenë viti 2005 kurse me më pakë viktima ka qenë viti 2013 po ashtu kemi rënie të krimeve të vrasjeve njehkosisht edhe për viktimat e krimeve të vrasjeve. Gjinia e krimeve të vrasjeve është një ndër karakteristikat e që është hulumtuar dhe është evidentuar po ashtu janë ndarë se sa ka

pasur viktimat të krimeve të vrasjeve të gjinisë femrore e sa ka pasur viktimat të gjinisë mashkullore , duke u bazuar në tabelën numër 3 të të dhënave statistikore të siguruar nga ana e policisë së Maqedonisë del se viktimat të krimeve të vrasjeve të gjinisë femrore janë 101 viktimat të krimeve të vrasjeve të gjinisë mashkullore janë 298 viktimat të vrasjeve nga kjo del se femrat janë më pak viktimizues të krimeve të vrasjeve se sa meshkujt , po ashtu kur kemi hulumtuar për mjetet e përdorura gjatë viktimizimit të vrasjeve në territorin e Maqedonisë nga Gjykata Themelore Tetovë si dhe Gjykata Themelore në Kumanovë , në Gjykatën themelore në Tetovë kemi siguruar se 58 vrasje që janë kryer janë përdorur armët e zjarit kurse vetëm në 8 vrasje janë përdorur arme të ftohta si dhe mjete të tjera të forta , kurse në Gjykatën e Kumanovës në bazë të statistikave të dhëna arma e zjarrit është përdorur në 89 viktimat të vrara kurse armët e ftohta apo mjetet të forta vetëm 16 viktimat të krimeve të vrasjeve. Në fund të këtij punimi shkencor kemi të dhëna për vrasjet e kryera , gjininë e vrasjeve si dhe për viktimat e krimeve të vrasjeve si dhe po ashtu mjetet e përdorura gjatë viktimave të vrarë.

LITERATURA

I.Zejneli

E drejta penale-pjesa e posacme(cikel leksionesh), Tetove, 2007

I. Zejneli-B.Netkova

Trafikimi me njerëz aspekte juridike, Tetovë, 2007

E Sahiti- I.Zejneli

E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017

V.Kambovski-I.Zejneli

E drejta penale-pjesa e pergjithshme, Tetove,2018

V. Kambovski

Kazнено pravo, poseben del, Shkup, 1997

V. Kambovski

Megjunarodno kazнено pravo, Shkup, 1998

I. Elezi

E drejta penale, pjesa e posacme, Tiranë, 1995

R.Halili

Viktimologjia, Prishtinë,2012

R. Halili

Kriminologjia, Prishtinë, 2016

R.Halili

Penologjia, Prishtinë,2015

S. Begeja

Kriminalistika, Tiranë, 1997

I. Salihu

E drejta penale-pjesa e posacme, Prishtinë, 2014

V. Latifi

Kriminalistika, Prishtinë, 2015

I.Elezi&V.Hysi

Politika kriminale, Tirane, 2006

E. Sahiti

Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë, 1993

E. Miftari

Këqyrja e vendit të ngjarjes, Tiranë, 1996

N. Shurbanovski

Po zatvorot kade, Shkup, 1993

Interneti

1. Osmani , Afrim , Kodi penal i RM-së 2010
2. ://ëëë.albeu.com.
3. ://ëëë.botasot.info

4. [:// ëëë.ilirida.net](http://ëëë.ilirida.net)
5. [:// ëëë.botasot.com](http://ëëë.botasot.com)
6. [:// portalb.com](http://portalb.com)
7. ëëë.library.seeu.edu.mk
8. <http://indeks.mk/index.php?pagename=read&neësid=9617>